

1 E martë, 21 janar 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.01

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar i
6 seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit. Ju faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
12 procesverbal të katërt të akuzuarit janë të pranishëm në
13 sallën e gjyqit sot.

14 Sot do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit të
15 Prokurorisë 02183. Përpara sesa të sillet dëshmitari në sallë,
16 Trupi Gjykses do nxjerrë një vendim me gojë lidhur me
17 parashtrimin e protokolluar F02837.

18 ZPS-ja parashtroi që miratimi i kërkesës për dëshmi
19 përmes videolidhjes do të siguronte shëndetin dhe mirëqenien e
20 dëshmitarit dhe nuk ishte cenues për të akuzuarit.

21 Në parashtrimet me gojë dje, Ekipte të ndryshme të
22 Mbrojtjes për të akuzuarit treguan që nuk kundërshtojnë
23 miratimin e dhënies së dëshmisë përmes videokonferencës për
24 Dëshmitarin 02714.

25 Zyra Administrative konfirmoi mundësinë e zhvillimit të

1 dëshmisë të Dëshmitarit 2714 përmes videolidhjes në
2 korrespondencë 713.

3 Trupi Gjykses rikujton që dëshmia përmes videolidhjes
4 jepet vetëm në raste përjashtimore, ndërkohë që prania e
5 dëshmitarit në sallën e gjyqit mbetet opsioni i preferueshëm.
6 Trupi Gjykses gjithashtu vlerëson që shëndeti, situata e
7 dëshmitarit bëjnë të mundur dhe e çojnë Trupin Gjykses për
8 miratimin e dëshmisë përmes videolidhjes. Trupi Gjykses
9 gjithashtu konsideron faktin që Mbrojtja nuk e kundërshton
10 kërkesën për dëshminë përmes videolidhjes.

11 Trupi Gjykses është i bindur që miratimi i kërkesës për
12 dhënien e dëshmisë përmes videolidhjes për Dëshmitarin 02714
13 nuk çon në cenim për të akuzuarit dhe Ekipet e Mbrojtjes janë
14 plotësisht në gjendje që të bëjnë pyetjet e nevojshme gjatë
15 marrjes në pyetje të dëshmitarit.

16 Trupi Gjykses gjithashtu është i bindur që marrja e
17 dëshmisë së Dëshmitarit 02714 përmes videolidhjes do të
18 kontribuojë për zhvillimin e shpejtë të procedurave.

19 Për këto arsye, Trupi Gjykses e miraton kërkesën e ZPS-së
20 në parashtrimin F02837 për autorizimin e dëshmisë së
21 Dëshmitarit 02714 për t'u zhvilluar përmes videolidhjes sipas
22 rregullës 144.

23 Ky është fundi i urdhrorit me gojë të Trupit Gjykses.

24 Znj. Sekretare, ju lutem silleni dëshmitarin ë sallë.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, mirëmëngjes.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Ndërkohë që sillet dëshmitari në
3 sallën e gjyqit, do kërkoj që të pranohen si prova gjyqësore
4 dy dokumente që unë i përdora dje me dëshmitarin.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një çast, ju
6 lutem. Mund të vazhdoni, z. Misetic.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Dokumenti i parë është DHT04111
8 deri në DHT04113, që është një artikull i *The Guardian* i vitit
9 1999.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, e kam
11 mbajtur shënim.

12 A keni kundërshtim, Prokurore?

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
15 DHT04111 deri në DHT04113 pranohet. Ju lutem caktojini një
16 numër.

17 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
18 Gjykatës. I caktohet numri 1D00238. Dhe klasifikohet si
19 publik.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. Dokumenti tjetër
21 është DHT04153 deri në DHT04157 që është një njoftim për shtyp
22 nga përfaqësuesi i posaçëm në detyrë z. De Mello.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
24 kundërshtim?

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
2 DHT04153 deri në 04157 pranohet në prova gjyqësore.

3 [Dëshmitari vijon dëshminë]

4 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Kjo do të marrë numrin e
5 provës 1D00239.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,
9 z. Strohmeyer.

10 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjes, z. Gjykatës.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem do
12 ju kujtoja që t'i përgjigjeni thjesht dhe me fjali të qarta
13 pyetjeve që do t'ju bëjnë sot. Në qoftë se nuk e kuptoni
14 pyetjen, lirisht mund t'i tregoni avokatëve që ta riformulojnë
15 dhe një herë pyetjen ose ta shpjegojnë më tej atë.

16 Po ashtu, mundohuni që të tregoni bazën e njohurive, të
17 fakteve dhe rrethanave mbi të cilat do të përgjigjeni.

18 Po ashtu ju lutem flisni pranë mikrofonit, bëni një pauzë
19 prej pesë sekondash përpara sesa të jepni përgjigjen dhe
20 flisni me ritëm të ngadaltë për hir të përkthyesve.

21 Nëse e shikoni që e keni të nevojshme që të bëni pushim,
22 na e bëni me dije këtë që dhe ne do të bëjmë organizimet
23 përkatëse.

24 Ju kujtoj që jeni ende nën detyrimin që të thoni të
25 vërtetën sikurse e deklaruat dje përmes deklaratës solemne. Ju

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 5

1 kujtoj gjithashtu garancitë e dhëna për ju të enjten -- ju
2 kërkoj ndjesë, nuk duhet ta kisha thënë këtë pjesën.

3 DËSHMITARI: HANSJOERG STROHMEYER [Vijon]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jeni gati që
5 të filloni, Dëshmitar?

6 DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic,
8 fjala për ju.

9 Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic:

10 [Vazhdim]

11 Z. MISETIC: [Përkthim]

12 PY. Mirëmengjes dhe një herë, z. Strohmeier.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Sekretar i seancës, do ju
14 kërkoja që të paraqisni në ekran dokumentin P1968, në
15 paragrafin 70, në faqen 18.

16 PY. Z. Strohmeier, do ju tregojmë dhe një herë deklaratën
17 tuaj, tema e radhës për marrjen në pyetje tuajën ka të bëjë me
18 Këshillin Kalimtar të Kosovës, të cilin ju e keni diskutuar
19 dhe në dëshminë me Prokurorinë. Shikoni paragrafin 70 të
20 deklaratës tuaj. Ju aty thoni, atëherë sa i takon KTK-së, z.
21 Thaçi ka caktuar vetëm emrat e UÇK-së. Ke thënë gjithashtu që
22 ai "nuk ishte i shqetësuar që të ishte gjithëpërfshirës, nuk
23 ka dashur që të përfshijë serbët apo pakica të tjera dhe madje
24 është përpjekur që të minimizojë ndikimin e grupeve të tjera
25 të shqiptarëve të Kosovë, të tillë si LDK-ja". A e shikoni

1 këtë pjesën, Dëshmitar?

2 PË. Sapo e lexoj, një çast, ju lutem.

3 PY. Atëherë si çështje paraprake, ky këshill, Këshilli

4 Tranzitor i Kosovës, ky përbëhej nga parti të ndryshme dhe

5 pakica të ndryshme etnike në Kosovë, apo jo?

6 PË. Po.

7 PY. Tani do ta quajmë KTK. Pra, në KTK ka pasur gjithashtu

8 edhe përfaqësues të UNMIK-ut dhe KFOR-it, apo jo, Dëshmitar?

9 Pra, në KTK ka pas përfaqësues edhe të UNMIK-ut dhe --

10 PË. Nuk më kujtohet.

11 PY. A ju kujtohet që në KTK ka pasur gjithashtu edhe

12 përfaqësues të komunitetit shqiptar të Kosovës?

13 PË. Po, disa. Më shumë se një domethënë.

14 PY. Në rregull.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Dua që të tregoj një version

16 anglisht të deklaratës tuaj, kështu që do i kërkoja Sekretarit

17 të paraqesë në ekran dokumentin DHT0454 në të majtë të ekranit

18 për ta krahasuar me atë çfarë keni thënë në deklaratën që

19 është tani në ekran.

20 PY. Është një artikull me autor Laura Rozen. Titulli është

21 "Kthimi i shkurtër i palumtur i Ibrahim Rugovës", mban datën

22 17 korrik 1999.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të kalojmë

24 në faqen e dytë të këtij dokumenti.

25 PY. Atëherë në paragrafin e dytë thuhet:

1 "Rugova dhe aleatët e vet po refuzojnë që të marrin pjesë
2 në Këshillin Tranzitor të mbështetur nga Kombet e Bashkuara,
3 në përjashtim të rastit kur ato do të merrnin më shumë vende
4 sesa forcat e tjera politike kryesore në Kosovë, në veçanti
5 UÇK-ja dhe LDB-ja.

6 "Ky qëndrim është në kundërshtim me marrëveshjen e rënë
7 dakord në biseda për paqen në Rambuje në Francë më 23 shkurt.
8 Atje, Rugova u pajtua që partia e tij, LDK, UÇK-ja dhe LDB-ja,
9 si dhe dy gazetarë të pavarur, secili do të merrnin dy vende
10 në Qeverinë e Përkohshme që do të qeveriste derisa të
11 mbaheshin zgjedhjet dhe që do të drejtohej nga udhëheqësi 30-
12 vjeçar i UÇK-së Hashim Thaçi si kryeministër.

13 "Tani partia e Rugovës kërkon që partia e LDK-së të marrë
14 një vend të tretë edhe ka bojkotuar bisedimet ndërkombëtare
15 për të formuar një qeveri të përkohshme në Kosovë derisa të
16 marrë këtë vend të tretë.

17 "Administratori i Kombeve të Bashkuara në Kosovë e
18 konsiderojnë Rugovën gjithnjë e më tepër dhe aleancat e tij të
19 ngushta si neutral. 'Ju lutem, në qoftë se keni mundësi
20 tregojini Rugovës që të ndalojë pengimin e formimit të
21 Këshillit të Përkohshëm Tranzitor', i tha një këshilltar i
22 inatosur i Kombeve të Bashkuara një gazetari përpara një jave
23 në Prishtinë. 'Kombet e Bashkuara do të vazhdojnë pa LDK-në në
24 qoftë se Rugova nuk mban fjalën e dhënë.'"

25 "Jam i mërziur që LDK-ja ka zgjedhur të mos marrë pjesë

1 në takimin e parë', tha Bernard Kouchner, ish-ministri i
2 shëndetësisë i Francës dhe themeluesi i Mjekëve Pa Kufij ..."

3 Më tej thuhet që:

4 "... UNMIK-u, tha që ata janë të palumtur, të pakënaqur
5 me përbërjen aktuale të këshillit.'" "

6 A ju kujtohet tani pasi lexuat këtë pjesë, Dëshmitar, që
7 ishte Rugova dhe LDK-ja palët të cilët po mundoheshin që të
8 bojkotonin krijimin e KTK-së sepse dëshironin që të kishin më
9 shumë vende në KTK, a është e saktë kjo?

10 PË. Besoj që është e saktë. Nuk më kujtohet ekzaktësisht, po,
11 besoj se po.

12 PY. Në qoftë se do të kalojmë tek faqja e tretë e këtij
13 artikulli.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë pak më poshtë, drejt
15 fundit.

16 PY. Thuhet, atëherë këtu flitet për kthimin e z. Rugova në
17 Kosovë:

18 "Por të enjten Rugova duke u dukur i zënë nga dielli dhe
19 në formë të mirë ... i veshur me një këmishë të bardhë dhe me
20 një kostum serioz, deklaroi se ai ende e konsideronte veten si
21 president të Kosovës. Ai shprehet:

22 "'Po, jam President', Rugova tha, pasi kishte mbërritur
23 në Kosovë i shoqëruar nga Christopher Hill. 'Jam shumë i
24 lumtur që po kthehem në Kosovën e lirë'."

25 A ju kujtohet që z. Rugova vazhdonte që të pretendonte që

1 të kishte statusin e Presidentit të Kosovës dhe që nuk e
2 merrte parasysh ose e injoronte Rezolutën 1244?
3 PË. E keni fjalën kur është kthyer z. Rugova?
4 PY. Po.
5 PË. Në qoftë se ju po më pyesni mua, në qoftë se mua më
6 kujtohet në qoftë se njerëzit i drejtoheshin si president
7 atij, përgjigja është që nuk më kujtohet. Por, besoj që fakti
8 që ne po mundoheshim të ushtronim trysni që z. Rugova të bëhej
9 pjesë e KTK-së, dëshmon për vetë faktin se ne po i kërkonim
10 atij që të luante sipas të njëjtave rregulla, siç i kërkonim
11 dhe gjithë palëve të tjera, domethënë, rregullave që ishin të
12 përcaktuara në Rezolutën 1244.
13 PY. Por arsyeja që pse ai dhe LDK-ja nuk kanë marrë pjesë ose
14 ishte fakti që ata po bojkotonin KTK-në, kështu?
15 PË. Nuk më kujtohet ekzaktësisht, po kështu duket sikur të
16 ketë qenë.
17 PY. Mënyra sesi UNMIK-u ose Kombet e Bashkuara i shpërndanë
18 vendet për përfaqësuesit e komunitetit shqiptar, sikurse e
19 lexuat dhe besoj dhe në artikull, ishte i mbështetur tek
20 marrëveshja për krijimin e Qeverisë së Përkohshme në shkurt,
21 por ju thatë që nuk ju kujtohet kjo, apo jo?
22 PË. Nuk më kujtohet ekzaktësisht. Pra, ka pasur shumë
23 dinamika që kanë çuar në krijimin e KTK-së, kam qenë i
24 përfshirë në takimin e parë të KTK-së, megjithatë nuk kam qenë
25 shumë i angazhuar në zhvillimet e KTK-së.

1 PY. Po si këshilltar juridik, a nuk keni luajtur rol ju për
2 mënyrën se si do të organizohej, do të krijohej KTK-ja?

3 PË. Kisha dhe shumë detyra të tjera për të bërë përveç
4 këshilltarit juridik, megjithatë realiteti ishte që puna për
5 krijimin e KTK-së kryesisht drejtohej nga departamenti
6 politik. Nuk po them që kam qenë i përjashtuar nga kjo punë,
7 por nuk është se kam pas rol kryesor për krijimin e KTK-së.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, dëshiroj që të
9 kërkoj pranimin në provë gjyqësore të këtij artikulli.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
11 kundërshtim?

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
14 DHT04951 deri në DHT04954 pranohet në prova gjyqësore.

15 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e
16 provës 1D00240. Klasifikimi është publik.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Le ta mbajmë tek faqja 71
18 dokumentin që kemi në djathtë.

19 PY. Këtu thuhet që ju keni parë një kabllogram që mban datën
20 3 korrik 1999 të cilat janë shënimet e një takimi më datë 30
21 qershor 1999 "ndërmjet Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit
22 të Përgjithshëm dhe përfaqësues shqiptarë, përfshirë këtu dhe
23 Hashim Thaçin dhe Jakup Krasniqin ...".

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Vijoje më me faqen tjetër.

25 PY. Vazhdon këtu dokumenti dhe thotë që:

1 "Thaçi nuk e dëshironte KTK-në në fillim, por ai e pranoi
2 atë dhe u përpoq që ta kontrollonte atë duke përfshirë
3 njerëzit e tij në të. Besoj që duke bërë veten një anëtar
4 prominent të njohur të KTK-së, Thaçi u përpoq që ta vendoste
5 veten si një ndër personat në pararojë për ta drejtuar Kosovën
6 kur KTK-ja të përfshihej në faza të tjera."

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë tek dokumenti në majtë,
8 dhe dokumenti nuk duhet të transmetohet për publikun. Bëhet
9 fjalë për provën P1975 që do i kërkoja Sekretarit ta paraqiste
10 në të majtë të ekranit.

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në mënyrë të
12 tillë që të diskutojmë për këtë dokument, do kërkoja që mbase
13 do ishte mirë të kalonim në seancë private.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk e di se cila është arsyeja që
15 pse duhet të kalojmë në seancë private.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për çfarë
17 arsye do të kalojmë në seancë private?

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Për sa i takon përdorimit të
19 këtij dokumenti, ky dokument i nënshtrohet kritereve të
20 rregullës 107.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të kalojmë
22 në seancë private.

23 [Seancë private]

24 [Seancë private teksti i fshirë]

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetić (Vazhdim)

Faqe 15

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetić (Vazhdim)

Faqe 16

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetić (Vazhdim)

Faqe 17

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetić (Vazhdim)

Faqe 18

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 19

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24 [Seancë e hapur]

25 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

2 PY. Z. Strohmeier, folëm për marrëveshjen e demobilizimit dhe
3 desha t'i kthehem një dispozite të veçantë të kësaj
4 marrëveshjeje.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se mund të kalojmë ju
6 lutem tek dokumenti P01444.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do të doja që të më
8 qartësonit. Dëshironi ta shfaqni në ekran ngjitur me
9 dokumentin tjetër?

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Më duket që është faqja e
11 fundit, 078204. Po.

12 PY. Ky është paragrafi 25 i marrëveshjes. Shikojeni këtë ju
13 lutem. Ju kujtohet kjo dispozitë në këtë marrëveshje,
14 angazhim?

15 PË. Po. Sapo e lexova, po.

16 PY. A ishit në dijeni të kësaj dispozite përpara se ta
17 lexonit?

18 PË. Besoj që e kam ditur në atë kohë. Po të kishit pyetur
19 para pesë minutash, ndoshta jo.

20 PY. Kjo është një dispozitë ku UÇK-ja thotë me terma konkretë
21 që po angazhohet, por kërkon që të merren parasysh gjerat e
22 tjera përfshirë, pra edhe përfshirjen e pjesëtarëve të UÇK-së
23 në forcën e policisë dhe formimin e ushtrisë së Kosovës në
24 formën e Gardës Kombëtare të Shteteve të Bashkuara?

25 PË. Po.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se mund të kalojmë në
2 dokumentin në anën e majtë në 1D00210.
3 PY. Ky është një artikull i *New York Times* ku i cili raporton
4 mbi faktin që angazhimi ishte nënshkruar dhe titulli është:
5 "Kriza në Ballkan: Analizë e përgjithshme: NATO shqyrton
6 mundësinë e lejimit të kosovarëve që të krijojnë ushtrinë e
7 tyre".

8 "Marrëveshja e arritur sot për shpërbërjen e ushtrisë --
9 marrëveshja e arritur sot më herët për shpërbërjen e Ushtrisë
10 Çlirimtare të Kosovës përfshirë edhe -- përfshiu pas
11 këmbënguljes së komandantit të tyre angazhimin nga aleatë të
12 NATO-s për të marrë parasysh mundësinë e lejimit që rebelët të
13 krijojnë një ushtri të përkohshme në Kosovë sipas modelit të
14 Gardës kombëtare të Shteteve të Bashkuara."

15 Në qoftë se kalojmë në faqen 2, nga mesi, paragrafi
16 fillon: "Ajo që ..." në mes, është një fjali që fillon:

17 "Por edhe disa aleatë të NATO-s, në veçanti Gjermania, e
18 kundërshtuan angazhimin në dokumentin përfundimtar.
19 Kundërshtimet nga krahu politik i NATO-s vonuan miratimin e
20 tij dhe nënshkrimin e tij deri në orët e para të këtij
21 mëngjesi dhe pse komandantët rebelë dhe zyrtarët ushtarakë të
22 NATO-s kishin arritur këtë marrëveshje që të shtunën në
23 mbrëmje, duke festuar këtë me *whiskey* irlandez në shtëpinë e
24 gjeneral Çekut në kohën e luftës në male në qendër të Kosovës.

25 "Gjermania pranoi vetëm pasi Sekretarja e Shtetit

1 Madeleine Albright u takua me ministrin e punëve të jashtme
2 gjermane, Joschka Fischer, gjatë një darke të dielën në darkë
3 në konferencën e fuqive të mëdha industriale në Cologne dhe i
4 shpjegoi që rebelët, udhëheqësit rebelë nuk do të pajtoheshin
5 ...”

6 Pra, në qoftë se kalojmë në faqen 5 të dokumentit,
7 paragrafi që fillon.

8 PË. Po.

9 PY. "... kjo pjesë e marrëveshjes vërtetoi që ishte pengesa -
10 - doli që ishte pengesa përfundimtare në bisedime që filluan
11 në nivelin ushtarak në Shqipëri të martën dhe vazhduan deri të
12 shtunën, ku z. Thaçi u përfshi si 'komandanti kryesor' i
13 rebelëve. Paragrafi që merret me ushtrinë është futur në
14 mënyrë të përsëritur dhe hequr, derisa negociatorët e NATO-s
15 kuptuan që rebelët nuk do të pajtoheshin pa këtë.

16 "Ne duhet që t'u tregojm atyre respekt', tha një
17 diplomat i lartë.

18 "Me pranimet që kemi bërë ne, rebelët, udhëheqësit rebelë
19 qartësisht ishin të kënaqur me marrëveshjen edhe pse për tani
20 do të thotë që atyre u jepen armët dhe ata armët duhet t'ia
21 dorëzojnë NATO-s. 'UÇK-ja kishte luftuar për të arritur sot
22 atë që arriti sot', tha Thaçi."

23 Tani, z. Strohmeier, të gjitha këto janë publikuar në *New*
24 *York Times* dhe, pra, ishte ditur në të gjithë botën që UÇK-ja
25 nuk do të pranonte angazhimin pa futjen, pa përfshirjen e

1 kësaj dispozite që ishte në marrëveshje. Dhe ju duhet ta
2 kishit ditur, besoj që e keni ditur në këtë kohë?
3 PË. Po.
4 PY. Kuptohet që u kuptua që UÇK-ja do të vazhdonte të ndiqte
5 objektivat e veta pas nënshkrimit të marrëveshjes?

6 PË. E saktë.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Duhet të kaloj në seancë private
8 për shkak të kushteve nga rregulla 107, kufizimet nga kjo
9 rregull.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
11 seancë private.

12 [Seancë private]

13 [Seancë private teksti i fshirë]

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetić (Vazhdim)

Faqe 24

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetić (Vazhdim)

Faqe 27

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

- 1 [Seancë private teksti i fshirë]
- 2
- 3
- 4
- 5
- 6
- 7
- 8
- 9
- 10
- 11
- 12
- 13
- 14
- 15
- 16
- 17
- 18
- 19
- 20
- 21
- 22
- 23
- 24
- 25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25 [Seancë e hapur]

1 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
3 pushim dhjetë minuta tani.

4 Dhjetë minuta pushim, z. Dëshmitar.

5 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] A mund t'i kërkoj Mbrojtjes të na
7 japin afatet kohore apo sa kohë ju duhet akoma Mbrojtjes për
8 të mbaruar me pyetjet e tyre?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Më ka ngelur vetëm tre faqe, z.
10 Kryetar.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni bërë
12 katër orë e gjysëm deri tani.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] E di dhe do mbaroj para orës
14 11.00. Dhe e kam biseduar me ekipet e tjera të Mbrojtjes dhe
15 nuk duhet, besoj që nuk do të tejkalojmë afatet që kemi apo
16 kohën që kemi kërkuar në tërësi.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca
20 ndërpritet.

21 --- Seanca ndërpritet në orën 10.01

22 --- Seanca rifillon në orën 10.11

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
24 sillni dëshmitarin në sallë.

25 [Dëshmitari vijon dëshminë]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

2 Z. Misetiç, mund të vazhdoni me pyetjet tuaja.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

4 I nderuar Kryegjykatës, ju lutem të kalojmë në seancë
5 private për të respektuar detyrimin e rregullës 107.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

7 [Përkthim] Ju lutem të kalojmë në seancë private.

8 [Seancë private]

9 [Seancë private teksti i fshirë]

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetić (Vazhdim)

Faqe 37

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

- 1 [Seancë private teksti i fshirë]
- 2
- 3
- 4
- 5
- 6
- 7
- 8
- 9
- 10
- 11
- 12
- 13
- 14
- 15
- 16
- 17
- 18
- 19
- 20
- 21
- 22
- 23
- 24
- 25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11 [Seancë e hapur]

12 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

13 Faleminderit.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

15 Z. MISETIC: [Përkthim]

16 PY. Z. Strohmeier, në faqen 9 të Shënimit Përgatitor numër 1,

17 ju keni thënë që asnjëherë nuk keni parë që z. Thaçi t'i jepte

18 urdhër gjeneral Çekut?

19 PË. Ky është ai shënimi që kemi përgatitor përpara disa

20 ditësh?

21 PY. Po.

22 PË. Po, korrekt.

23 PY. Dhe nuk keni parë në fakt që z. Thaçi t'i jepte urdhër

24 ndokujt në UÇK ndonjëherë, apo jo?

25 PË. Nuk më kujtohet. Nuk mund të them as po as jo. Nuk më

1 kujtohet ndonjë rast konkret.

2 Po unë të paktën nuk e kam parë që të ketë dhënë urdhra
3 në praninë time një komandanti apo ndonjë personi. Më janë
4 bërë disa herë pyetje për këtë. Sepse z. Thaçi nuk ka marrë
5 pjesë në takimet e KPI-së. Por në një a dy takimet që kam
6 pasur unë me ata të dy bashkë, nuk e kam parë një rast të
7 tillë, nuk kam parë të ketë ndodhur të ketë ndodhur diçka e
8 tillë.

9 PY. Faleminderit. Në një nga shënimet përgatitore të javës së
10 kaluar bëhet fjalë për Shënimin Përgatitor numër 2, paragrafi
11 3, ju keni thënë, citoj:

12 "UNMIK-u mësoi se kush ishte personi që duhet të
13 kontaktonim ne dhe nga ana ushtarake ishte Çeku, nga ana
14 politike ishte Thaçi."

15 Kështu?

16 PË. Ky ishte perceptimi im. Mbjaj mend që për aspekte politike
17 duhet t'i drejtohem z. Thaçi, ndërsa për këtë marrëveshjen
18 dhe për çështje që lidheshin me KPI-në duhet t'i drejtohem
19 ose mendonim që z. Çeku ishte personi i kontaktit.

20 PY. Në rregull.

21 PË. Më lejoni të shtoj diçka. Sipas nesh ose dhe mënyra sesi
22 e kishim kuptuar ne ndonëse nuk e kemi shprehur, mendojmë që
23 ka pasur një hierarki, ka ekzistuar një hierarki. Për
24 shembull, nëse do pyesnit personat në UNMIK kush janë
25 përgjegjës në UÇK, të gjithë do thonin z. Thaçi.

1 PY. Nuk na interesojnë anketat, s'po bëjmë anketa këtu.

2 PË. Jo, thjesht po ju tregoj sesi mendohej asokohe.

3 PY. Na intereson ajo që keni parë me sytë tuaj.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Tema ime e fundit që do ta gëzojë
5 dhe Kryegjykatësin, por fatkeqësisht do të duhet të kalojmë në
6 seancë private për shkak të kufizimeve që na imponon rregulla
7 107.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

9 Të kalojmë në seancë private.

10 [Seancë private]

11 [Seancë private teksti i fshirë]

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 43

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 46

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetić (Vazhdim)

Faqe 47

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetić (Vazhdim)

Faqe 48

- 1 [Seancë private teksti i fshirë]
- 2
- 3
- 4
- 5
- 6
- 7
- 8
- 9
- 10
- 11
- 12
- 13
- 14
- 15
- 16
- 17
- 18
- 19
- 20
- 21
- 22
- 23
- 24
- 25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17 [Seancë e hapur]

18 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

19 jemi në seancë publike.

20 Z. MISETIC: [Përkthim]

21 PY. Z. Strohmeier, faleminderit që ju përgjigjët pyetjeve të

22 mia. Faleminderit dhe Trupit Gjykses që më la më tepër kohë.

23 Kaq pyetje kisha për ju, faleminderit edhe një herë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dixon.

25 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

1 Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon:

2 Z. DIXON: [Përkthim]

3 PY. Mirëmëngjesi, z. Strohmeier. Unë jam Rodney Dixon. Jam
4 avokat i z. Veseli. Kam disa pyetje për ju. Shpresojmë që do
5 përfundojmë shpjet. Do ju kërkoja që të jepni përgjigje të
6 shkurtra, pra, të thoni në qoftë se pajtoheni me atë çfarë do
7 ju pyes unë apo jo, në mënyrë të tillë që të vazhdojmë shpejt.

8 Do filloj pikësëpari lidhur me atë çfarë keni thënë në
9 seancën përgatitore në Shënimin Përgatitor 2, në paragrafin
10 21, nuk është e nevojshme që të paraqitet në ekran, megjithatë
11 do t'jua përmbledh. A ju kujtohet që keni thënë që nuk ju
12 kujtohet në qoftë se jeni takuar personalisht me z. Veseli ose
13 që ta keni ditur se çfarë roli ka pasur z. Veseli?

14 PË. Po, është e saktë. Edhe sot nuk më kujtohet kjo gjë.

15 PY. A ta kuptojmë këtë që juve nuk ju kujtohet të keni pasur
16 ndonjë takim drejtpërdrejt me z. Veseli kur keni qenë në
17 Kosovë apo të keni thënë ndonjë gjë drejtpërdrejt atij, a
18 është e saktë kjo?

19 PË. Po. Absolutisht e saktë edhe sot e kësaj dite nuk më
20 kujtohet ndonjë gjë e tillë.

21 PY. Mbase mund ta dini, mbase nuk mund ta dini por Gjenerali
22 Jackson ka dhënë një deklaratë. Dhe në vend që të kërkojë që
23 të paraqitet në ekran do bëj një përmbledhje të paragrafit 70
24 dhe në të Gjenerali Jackson thotë që:

25 "Mua nuk më kujtohet të kem pasur ndonjë ndërveprim me

1 Kadri Veselin apo ZKZ-në/SHIK-un."

2 Me aq ju kujtohet ju tani, a mbani mend ndonjë gjë që
3 gjenerali Jackson t'ju ketë thënë juve ndonjë gjë lidhur me z.
4 Veseli, me ndonjë takim të mundshëm me z. Veseli?

5 PË. Për gjeneralin Jackson e keni fjalën?

6 PY. Po.

7 PË. Jo, nuk më kujtohet.

8 PY. A pajtohemi ne sesi nga aspekti civil dhe ai ushtarak nuk
9 ka pasur ndonjë kontakt me z. Veseli gjatë kohës që ju keni
10 qenë atje? A e kujtoni kështu?

11 PË. Unë flas vetëm për vete. Nuk e di për të tjerët në qoftë
12 se kanë pas informacion nga aspekti civil persona të tjerë.

13 Por, personalisht, mund të them që mua, vetë, nuk më kujtohet
14 absolutisht asnjë rast kur mund të jem takuar me z. Veseli.

15 PY. Ka dëshmi në këtë çështje gjyqësore dhe nuk do ju pyes që
16 të komentoni lidhur me këtë aspekt.

17 Z. DIXON: [Përkthim] Po për ata që na ndjekin bëhet fjalë
18 për provën 2D00018.

19 PY. Ka prova, pra, që tregon që z. Veseli për një pjesë të
20 konsiderueshme të kësaj kohe ka qenë jashtë shteti. A jeni ju
21 në dijeni tani, duke parë nga perspektiva e së shkuarës, a
22 jeni në dijeni që z. Veseli nuk ka qenë në Kosovë për pjesën
23 më të madhe të kësaj kohe?

24 PË. Mbase unë as nuk e dija fare se kush ka qenë z. Veseli në
25 atë kohë. Kështu që për mua nuk ishte me interes të dija në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeier (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 52

1 qoftë se ka qenë në Kosovë apo jashtë Kosove, pra, për mua z.
2 Veseli ishte askushi, nuk e dija kush ishte, domethënë, me
3 fjalë të tjera, kështu që nuk mund të them.
4 PY. Faleminderit. Do t'jua bëj ndryshe pyetjen. A keni qenë
5 të informuar në atë kohë, ndoshta nuk i përgjigjeni dot kësaj
6 pyetjeje, por në përgjithësi dua t'ju pyes a e dini ju që ka
7 pasur takime të ZKZ-së ose të shërbimit inteligjent që
8 ndodheshin, që zhvilloheshin jashtë shteti midis shërbimit
9 kombëtar të Kosovës dhe shërbimeve inteligjente kombëtare nga
10 vende të tjera si në aspektin civil për të ndihmuar për
11 krijimin e një strukture inteligjente kombëtare brenda
12 Kosovës, domethënë, pak a shumë e njëjta gjë që bënte UNMIK-u
13 po që ishin takime që zhvilloheshin jashtë Kosove?

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] E kundërshtoj, cili është
15 themeli.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
17 përgjigjuni.

18 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk më kujtohet një gjë e tillë.
19 Nuk më kujtohet që po krijohej ose po bëheshin biseda,
20 diskutime për krijimin e një shërbimi inteligjent jashtë
21 Kosovës, nuk kam pasur një informacion të tillë për shtete të
22 caktuara anëtare që kanë ndihmuar ose kanë mbështetur krijimin
23 e një strukture të tillë.

24 Z. DIXON: [Përkthim]

25 PY. Në rregull. A pajtoheni me mua se mbështetur në përvojën

1 tuaj në Kombet e Bashkuara dhe përvojës në përgjithësi për
2 trajtimin e situatave post-konflikti, a pajtoheni me mua se
3 është e rëndësishme për shërbimet kombëtare të inteligjencës
4 të punojnë së bashku, si ato, domethënë, që funksionojnë
5 brenda vendit dhe ato që janë jashtë vendit, në mënyrë të
6 tillë që të mbledhin informacion edhe që të parandalojnë
7 konfliktet apo ta mbajnë vendin të sigurtë?

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kundërshtoj, është argumentative
9 dhe hamendësuese.

10 Z. DIXON: [Përkthim] Thjesht po e pyes që të më japë
11 mendimin e tij sipas përvojës së tij.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Së pari
13 pyeteni për përvojën e tij në qoftë se e ka këtë përvojë.

14 DËSHMITARI: [Përkthim] Sa për ta sqaruar, ju e keni
15 fjalën për vende jashtë Kosove, domethënë, e keni fjalën për
16 shtetet anëtare ndërkombëtare, për këtë e keni fjalën?

17 Z. DIXON: [Përkthim]

18 PY. Po.

19 PË. Presupozoj që kështu ka qenë rasti. Megjithatë nuk është
20 se dua të futem në hollësi, por në Timorin Lindor ne kemi
21 punuar ngushtë me Australinë dhe bëhej fjalë për informacion
22 që shkonte përtej konstatimeve tona civile. Supozoj që ka
23 pasur dhe raste të tjera, për shembull, në rastin e Sudanit
24 kam qenë i përfshirë me shërbimet e inteligjencës në të gjitha
25 anët, në të gjitha krahët.

1 Kështu që e kuptoj plotësisht që ka operacione
2 inteligjence që ndodhin ndërkohë që kemi qenë aty, domethënë,
3 kjo është thjesht një prezumim, një supozim i përgjithshëm.
4 Pra, këto lloj gjërash ndodhin për ta thënë në vija të
5 përgjithshme. Nuk dua që të mbërrij në ndonjë përfundim
6 konkret në këtë. Megjithatë, në qoftë se më lejoni? Dua të
7 shtoj që ndonjëherë mund të ndihmojë që ti të krijosh një lloj
8 qasje të caktuar, një vend të caktuar. Pra, shërbimet e
9 inteligjencës kryesisht, domethënë, kanë burime në terren,
10 kështu që ti gjëra të caktuara ose ngjarje të caktuara i
11 konstaton, domethënë, nuk është ti kontakton në mënyrë të
12 drejtpërdrejtë me persona që janë pjesë e shërbimit
13 inteligjent por ndërkohë konsultohesh ose takohesh me
14 ambasadorin ose stafin e ambasadës në mënyrë të tillë që të
15 merret informacion më shumë lidhur me atë çfarë ndodhë në
16 terren.

17 Në pjesën më të madhe të rasteve kemi pasur probleme për
18 sa i takon krijimit të përgjithshëm të UNMIK-ut me dhe
19 kapacitetit civil të saj, të UNMIK-ut por gjithashtu kemi
20 pasur informacion, mungesë informacioni reale ose kapacitete
21 për të mbledhur informacion të qenësishëm dhe për këtë arsye
22 kemi kontaktuar me shtetet anëtare sipas të cilëve -- sipas
23 mendimit tonë këto shtete anëtare kishin informacion më shumë
24 se ne ose më cilësor sesa ne.

25 PY. Nga kjo përvojë e juaja, a është e drejtë të arrihet në

1 përfundimin që në rrethanat pas konfliktit ose post-
2 konfliktit, në Kosovë në veçanti, të pasurit të një shërbimi
3 inteligjent të trajnuar siç duhet dhe të shëndetshëm ka qenë
4 një pjesë kritike për sigurimin e stabilitetit dhe zhvillimin
5 e vendit në të ardhmen?

6 PË. E keni fjalën për shërbimin inteligjent të Kosovës?

7 PY. Po, po shërbimin civil kombëtar inteligjent.

8 PË. Me thënë të drejtën, nuk e kam menduar këtë aspekt.

9 Megjithatë në qoftë se do ta shohim sot Kosovën si shtet pa
10 diskutim që shteti çdo shtet ka nevojë për shërbimin e
11 inteligjencës. Në qoftë se më pyesni konkretisht në qoftë se
12 duhet që të kishin pasur ata një shërbim inteligjent në kohën
13 kur UNMIK-u ka qenë i pranishëm në Kosovë dhe kur po krijonte
14 administratën sipas Rezolutës 1244, përgjigja ime do kishte
15 qenë jo, sepse ky do të kishte qenë një institucion paralel me
16 ne, pra, me UNMIK-un.

17 PY. Në fakt ju nuk është se jeni hasur ose nuk është keni
18 dëgjuar ndonjëherë për shërbim inteligjent kombëtar ose civil
19 gjatë kohës që kur keni qenë atje?

20 PË. Jo, jo mesa më kujtohet.

21 PY. Do të kalojmë në paragrafin 20 të deklaratës tuaj. Do të
22 kalojmë në një pyetje pak më të përgjithshme.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Është prova P1968. Do i kërkoja
24 Sekretarit ta paraqesë në ekran se mbase mund të na ndihmojë.
25 Paragrafi 20, ju lutem.

1 PY. Në mes të paragrafit ju thoni që:

2 "Më herët, ka pasur shumë trysni për të mbushur mangësitë
3 e rendit dhe në veçanti njerëzit që arrestoheshin nga KFOR-i
4 ju thoni që nuk keni pasur eksperiencë institucionale për
5 krijimin e sistemeve ligjore ose gjyqësore në atë kohë."

6 Thoni gjithashtu që:

7 "Nuk është se keni pasur kapacitete gjyqësore ose modele
8 mbi të cilët ju të mbështeteshit."

9 Nga përvoja juaj, a pajtoheni ju që vërtetë ju kishit
10 detyrë të vështirë sa i takon krijimit të një force policore
11 që mund të hetonte dhe që mund t'i dërgonte çështjet përpara
12 gjykatës, domethënë, që ta krijonit nga hiçi, nga zeroja një
13 strukturë të tillë?

14 PË. Po, jam plotësisht dakord.

15 PY. Ju nuk ishit të përfshirë në luftime. Domethënë, thjesht
16 kishit aftësinë që të përqendroheshit në këtë çështje dhe,
17 pavarësisht kësaj, puna ishte goxha e vështirë, apo jo?

18 PË. Gjatë javëve të para unë jua përshkrova situatën dhe më
19 herët, pra, që ka pasur dhe përplasje, përleshje, luftime,
20 megjithatë, pra, unë më duhet të them që ne na duhej që të
21 reagonim në situatë dhe për këtë arsye, besoj, se kjo është
22 arsyeja pse kam dhënë ato shpjegime në fillim të paragrafit
23 20.

24 Ne jemi hasur me një situatë shumë të ngjashme në Timorin
25 Lindor më vonë ku Australia ndërhyri, domethënë, Australia ka

1 luajtur pak a shumë të njëjtin rol që ka luajtur KFOR-i në
2 Kosovë dhe "Neve kemi bërë arrestime për arsye të ndryshme.
3 Megjithatë ne nuk jemi mandatuar për të ndjekur penalisht ose
4 për të kryer funksione ligjore ose të rendit". Dhe ne jo vetëm
5 që kemi zhvilluar një sistem për të pasur këto struktura por
6 gjithashtu edhe për të pasur mundësi për t'i trajtuar ato
7 çështje në terren.

8 PY. Ju jeni përpjekur që ta bëni këtë gjë në raste *ad hoc* ose
9 në rast pas rasti, megjithatë ju nuk është e keni zhvilluar
10 sistemin që nga fillimi, apo jo?

11 PË. Po, ekzaktësisht kështu. I jemi përgjigjur rast pas
12 rastit situatave dhe sigurisht që përgjigja ka qenë larg të
13 qënurit perfekte, megjithatë ne kemi refuzuar, ne kemi reaguar
14 për të refuzuar në një mënyrë që NATO-ja të kryente këto
15 funksione sepse në aspektin operativ, besoj që më kuptoni për
16 çfarë e kam fjalën, ne kemi pasur disa biseda megjithatë i
17 gjithë projekti jonë si Kombe të Bashkuara, si UNMIK, sipas
18 Rezolutës 1244, ishte që të krijonim një administratë që
19 kishte të bënte me transparencën, që të mbështetej në rregulla
20 dhe në ligje dhe në qoftë se bëhej një arrestim, pavarësisht
21 se kush e bënte arrestimin, ne duhet të merrnim masat për të
22 pasur një proces të rregullt trajtimi ose proces të rregullt
23 ligjor dhe transparence.

24 Pra, ju i referoheni përgjigjes rast pas rasti por kjo
25 kishte të bënte gjithashtu edhe me masat që lidheshin me

1 procesin e duhur ligjor juridik.

2 PY. Nuk është e nevojshme që të kalojmë në pjesë të caktuara
3 të deklaratës tuaj, megjithatë ka pjesë të cilat janë
4 kontroverse në atë çfarë keni dhënë si deklaratë, për
5 shembull, në paragrafin 12 ju thoni që:

6 "Asnjëherë më përpara Kombet e Bashkuara nuk kishin --
7 nuk i ishin dhënë kompetenca dhe përgjegjësi të tilla
8 ekzekutive kaq shumë të gjëra mbi një territor të caktuar."

9 Kjo ishte e paprecedentë si situatë. Dhe ju në fakt keni
10 marrë përgjegjësi për çdo lloj gjëje që ka ndodhur atje, apo
11 jo?

12 PË. Kam dashur të them që kjo ka qenë, për shembull, Sergio
13 gjithmonë referohej, do më referohej me mua në gjermanisht si
14 *Bundesminister*, si një lloj ministri i drejtësisë, që nuk më
15 pëlqente ky termi kaq shumë me thënë të drejtën, por kjo e
16 reflekton situatën *de facto* në terren.

17 PY. Edhe një herë, UÇK-ja, ju në fakt në paragrafin 34 thoni
18 që ka pasur përgjegjësinë e vetme për t'i marrë këto
19 funksione, pra, për hetimin dhe ndjekjen në atë kohë?

20 PË. Kur thoni ju e keni fjalën për UNMIK-un?

21 PY. Po, për UNMIK-un.

22 PË. Sipas Rezolutës 1244, po.

23 PY. Tani sa i takon UÇK-së ose FARK-ut të LDK-së, ato nuk
24 mund të përfshiheshin për kryerjen e hetimeve vetë, a është e
25 saktë kjo?

1 PË. Është e saktë. Kështu e kemi kuptuar neve. Në fakt, siç
2 ishte situata. Ne po krijonim një forcë policore, por një prej
3 vonesave ose problemeve kryesore ishte që ndërkohë që shtetet
4 ishin të gatshme që të ofronin oficerë policie në nivel
5 konstatimi ose shqyrtimi nën Kreun 6 të forcës policore,
6 mandati ekzekutiv ose për shembull, një person ndërkombëtar që
7 nuk ishte, domethënë, nga Kosova, pra, mbante armë dhe mund të
8 performonte, për shembull, mandat ekzekutiv megjithatë fakti
9 që nuk mund të përdorej arma ose mund të kishte, për shembull,
10 pengesa kryesore për sa i takon kryerjes së këtyre detyrave,
11 shumë shtete e kishin problem për këtë.

12 Ky ishte element ekzekutiv, ne duhej që ta mbronim këtë
13 pozicion përditë por nga ana tjetër ne kishim vështirësi në
14 sigurimin e mbështetjes së plotë të shteteve anëtare për ta
15 përmbushur mandatin që na ishte dhënë përmes Rezolutës 1244.
16 PY. Këto vështirësi në fakt i cekët dhe më herët.

17 Z. DIXON: [Përkthim] Tani të kalojmë në paragrafin 20
18 përsëri. Do i kërkoja Sekretarisë që ta paraqesë dhe në ekran
19 paragrafin 20 në mënyrë që mund ta shohim.

20 DËSHMITARI: [Përkthim] E kam përpara ekranit.

21 Z. DIXON: [Përkthim] Po, duhet të jetë në ekran ende.

22 PY. Ju këtu në këtë paragraf thoni që:

23 "Ndërkohë që Serbia ka luajtur një rol të madh në
24 ngjarjet e dhunshme pas shpërbërjes së Jugosllavisë,
25 sigurisht, asnjë grup njerëzish nuk janë domosdoshmërisht ata

1 'të këqijte' për se ..."

2 Ju me të drejtë këtu identifikoni se në rolin tuaj në
3 veçanti si pjesë e Kombeve të Bashkuara, nuk duhet të bëhen
4 përgjithësime sa i takon grupeve, domethënë, përgjithësimi nuk
5 duhet të bëhet mbi bazën e grupit. Por përgjithësimi,
6 domethënë, duhet që të bëhet një vlerësim rast pas rasti
7 mbështetur në një individ të caktuar?

8 PË. Në këtë kontekst unë kam përmendur dhe një përvojë
9 konkrete nga Bosnja. Për shembull, atmosfera kur u ktheva unë
10 nuk është se ishte shumë e ndryshme nga Sarajeva, ku njerëzit,
11 zakonisht, e kishin tendencën të arrinin shpejt në përfundime
12 për t'ju hedhur fajin serbëve. Ndërkohë që kishte shumë
13 probleme ose probleme të mbivendosur. Shpesh ti mund të
14 haseshe me persona me të cilët mund të punoje dhe të cilët
15 shpresonin që të krijoheshin kushtet për të cilat ne ishim
16 aty.

17 Domethënë, pak a shumë këtë doja të thoja për mes këtij
18 shpjegimi që kam bërë këtu.

19 PY. Dhe me të drejtë në fakt. Edhe kjo duhet të aplikohet ose
20 të zbatohet me përgjithësi edhe për shqiptarët e Kosovës,
21 domethënë, nuk mund të arrihet në një përfundim në përgjithësi
22 që të gjithë ishin të këqij ose qoftë eshë për sa i takon UÇK-
23 së. domethënë, qasja e duhur është që të mos bëhen
24 përgjithësime. A është e saktë kjo?

25 PË. Sikurse e thashë edhe dje në përgjigje të një prej

1 pyetjeve, përshtypja ime faktikisht ishte që nga këndvështrimi
2 im, domethënë, nga ato javë të para, ishte që ne kemi parë
3 popullatë civile shqiptare të Kosovës që ishin të gatshëm për
4 hakmarrje, pra, besoj ose shpresoj të paktën që -- ose ta them
5 me fjalë të tjera, domethënë, ky ka qenë qëndrimi i
6 përgjithshëm i imi ose përgjithësimi i situatës, por gjithsesi
7 nuk mund të thuhet që domosdoshmërisht këta kanë qenë personat
8 e këqij në rastet e konflikteve.

9 PY. Po besoj që pajtoheni me mua që është e rëndësishme që të
10 mos bëhen përgjithësime të tilla, por të mund t'i vendoset
11 gishti atyre që vërtetë kanë qenë përgjegjës, pra, që
12 vlerësimi të bëhet rast pas rasti?

13 PË. Po.

14 Z. DIXON: [Përkthim] E shikoj kohën, i nderuar Gjykatës,
15 mbase do ishte mirë që të bëjmë pushim tani dhe pastaj të
16 vazhdojmë me pjesën tjetër të pyetjeve të mia.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

18 Dëshmitar, do bëjmë pushim tani për gjysmë ore.

19 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull.

20 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë

22 pushim për gjysmë ore deri në orën 11.30.

23 --- Pauza fillon në orën 11.00

24 --- Seanca rifillon në orën 11.30

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sillni

1 dëshmitarin në sallë, ju lutem.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

4 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

5 A mund të shfaqim në ekran dokumentin P743.4?

6 PY. Z. Strohmeier, ky është parafjala që ju treguat dje e
7 raportit të Sandra Mitchell, "Treguar siç është parë".

8 Parafjala është nga z. Kouchner. Juve ju tregua një pjesë e
9 saj dje lidhur me individët që kanë kryer krimet e pretenduara
10 që nuk ishte si politikë, pra. Dua t'ju referoj te një pjesë
11 tjetër e kësaj parafjale, dhe t'ju kërkoj përgjigjen tuaj.

12 Z. DIXON: [Përkthim] Në qoftë se mund të kalojmë tani për
13 këtë qëllim në faqen 076682, që është faqja e parë e
14 parafjalës, parathënies, dhe paragrafi në fund të faqes ku
15 fillon, "në shumë raste ...".

16 PY. Ta lexoj këtë për juve:

17 "Në shumicën e rasteve të dokumentuara nga OSBE-ja në
18 këtë raport ..."

19 Ky është raporti nga drejtori, drejtoresha e të drejtave
20 të njeriut Sandra Mitchell.

21 "... ka tregues të, seriozë që për kryerësit e shkeljeve
22 të të drejtave të njeriut janë ose pjesëtarë apo ish-pjesëtarë
23 të UÇK-së, njerëz që paraqiten si pjesëtarë apo ish-pjesëtarë
24 të UÇK-së, dhe pjesëtarë të grupeve të armatosura të tjera
25 shqiptare. Në rastet e tjera kryerësit e pretenduar janë

1 pjesëtarë të forcave apo grupeve të armatosura serbe. Në shumë
2 raste deri tani ka qenë e pamundur të identifikohen personat
3 përgjegjës për këto. Cilido qoftë identiteti i tyre, këto
4 grupe të armatosura duket që veprojnë në një mënyrë të
5 organizuar dhe kanë një lloj hierarkie, komande dhe kontrolli.
6 Për rrjedhojë, është përgjegjësia e atyre që mbajnë pozita me
7 ndikim që në të gjitha bashkësitë e komunitetet e Kosovës që
8 t'i dënojnë këto shkelje të të drejtave të njeriut dhe
9 kryerësit e tyre.

10 "Është përgjegjësi e përgjegjësve, që jemi ne, të
11 komunitetit ndërkombëtar për të transmetuar dhe theksuar këtë
12 mesazh."

13 E shikoni këtë pjesë?

14 PË. Po. E pashë pjesën e shënuar.

15 PY. Vazhdon në faqen tjetër.

16 PË. E kuptoj, e kuptoj.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dixon, po
18 flisni në të njëjtën kohë.

19 Z. DIXON: [Përkthim] Kërkoj ndjesë, të nderuar Gjykatës.

20 Mund të kalojmë në faqen tjetër që të shohim pjesën e
21 fundit që ka të bëjë me bashkësinë ndërkombëtare.

22 PY. Pra, tani që e keni të qartë, dhe i keni të gjitha
23 informacionet, ky, kjo parathënie iu tregua dhe Sandra
24 Mitchell kur ajo dha dëshmi, dhe kjo është në faqen 108574 për
25 ata që ndjekin, dhe ajo pranoi këtë vlerësim, u pajtua me këtë

1 vlerësim të z. Kouchner.

2 Pyetja ime për juve është: Nga ajo që ju kujtohet në atë
3 kohë, a është kjo një vlerësim i saktë i situatës të
4 përshkruar në këtë, që kishte grupe të ndryshme të mundshme që
5 mund të ishin përgjegjës për shkelje dhe që në shumë raste
6 ishte e, nuk ishte e ditur se kush ishte përgjegjës?

7 PË. Në qoftë se më kujtohet saktë nga dje, ky është raporti i
8 nëntorit.

9 PY. Po.

10 PË. Mendoj që është e rëndësishme të kuptojmë që mënyra se si
11 e kemi kuptuar ne dhe kjo lidhet me pyetjen tuaj të mëhershme
12 lidhur me aftësitë tona për shërbimet e inteligjencës, sa më
13 shumë që ishim në terren aq më mirë e kuptonim ne situatën,
14 dhe kjo mund të pasqyrojë saktë situatën në tërësi. Pra, është
15 diçka që ndoshta bëhet më e qartë pastaj në nëntor dhe neve na
16 është paraqitur në, më qartë se sa ajo që ne pamë dhe
17 konstatuam në qershor apo korrik.

18 PY. A mund të qartësoj pak më shumë nga përgjigjja juaj? Pra,
19 ju pranoni se kjo pasqyron një vlerësim të saktë të situatës
20 gjatë gjithë periudhës, duke filluar nga qershori deri në
21 nëntor, kur ky raport është përpiluar. Pra, mbulon gjithë këtë
22 periudhë kohore.

23 PË. Nuk mund ta them këtë gjë. Ajo që mund të them është që
24 në momentin kur është shkruar, mund të ketë qenë vlerësim,
25 gjykim për të gjithë periudhën, sepse në këtë kohë kishim më

1 shumë hollësi, më shumë informacione për situatën. Mënyra se
2 si ne e kemi parë, konstatuar, të paktën unë, në qershor,
3 fillim të korrikut, në atë periudhë pesë-gjashtë javore kur
4 unë isha aty, situata nuk ishte kaq e qartë siç është shprehur
5 këtu.

6 PY. Por ju e pranoni që ajo që është thënë këtu është qëndrim
7 i saktë sepse OSBE-ja në fakt po i hetonte këto raste dhe po
8 mblidhte, grumbullonte prova për të mbështetur gjetjet,
9 konstatimet e tyre?

10 PË. Nuk mund të, nuk më përket mua që ta them këtë gjë. Unë
11 mund të them vetëm atë që ishte perceptimi im, apo i yni, në
12 fillim. Dhe ky perceptim nuk ishte tërësisht në përputhje me
13 pasqyrimin e situatës në mënyrë të hollësishme në këtë raport.
14 Por, pranoj që në retrospektivë, ky mund të jetë interpretimi
15 i saktë i situatës.

16 PY. Tani në retrospektivë është më e lehtë dhe duke parë
17 provat relevante pajtoheni që ky raport është vlerësim i
18 saktë, siç është thënë këtu.

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kundërshtim. Pyetje e bërë dhe e
20 përgjigjur.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

22 Z. DIXON: [Përkthim]

23 PY. Atëherë, ta bëj pyetjen ndryshe. Tani që keni mundësi dhe
24 me distancë, pra, dhe në retrospektivë të shikoni të gjitha,
25 tërësinë e gjërave, pajtoheni se ishte pak e tepërt të thuhet

1 se të gjitha krimet ishin kryer, kryheshin nga UÇK-ja? Në fakt
2 kishte disa grupe të -- grupacione të ndryshme të kryerësve të
3 mundshëm, dhe në shumë raste kryerësit nuk njiheshin, nuk
4 dihej kush ishin.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kundërshtim. Nuk ka bazë për këtë
6 pyetje.

7 Z. DIXON: [Përkthim] Baza --

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
9 ka mendim, mund ta japë.

10 DËSHMITARI: [Përkthim] Do të thotë, do të përsëris atë që
11 thashë më përpara. E kam fjalën që unë mund të jap dëshmi për
12 përfundime dhe përshtypje që kemi patur. Ky është vlerësim.
13 Siç e thashë që është gjatë, me më shumë informacione që janë
14 marrur më vonë. Unë nuk kam qenë aty, nuk kam kontribuar në
15 këtë raport dhe nuk mendoj që është detyrë e imja të gjykoj
16 këtë, të them nëse është i saktë apo më i saktë se ajo që ne
17 kemi vërejtur.

18 Mund të jap dëshmi për atë që përshtypja dhe përfundimi
19 që kemi nxjerrur për nga disa fakte që na janë paraqitur neve
20 në atë kohë, gjatë aty javëve.

21 Z. DIXON: [Përkthim]

22 PY. Pajtoheni me mua, pra, që vlerësimi juaj është bazuar në
23 përshtypje dhe jo në hetime që ju keni bërë lidhur me këto
24 raste?

25 PË. Unë personalisht nuk kam bërë hetime. Rastet e shkeljeve

1 të të drejtave të njeriut në atë kohë janë hetuar në atë kohë
2 apo përcjellur kryesisht nga departamenti i OSBE-së, i
3 udhëhequr nga Sandra Mitchell, dhe natyrisht ne kemi krijuar
4 këto panelet, apo fillimin e procesit gjyqësor për të marrë
5 përsipër dhe vazhduar më tej, për të bërë verifikime të
6 mëtejshme.

7 Tani, dhe duke u kthyer tek pika e parë, pyetjet lidhet
8 me shërbimet e inteligjencës, ne kishim informacione
9 inteligjence tërësisht të paplota në javët e para. Dhe në këtë
10 rast ne shumë jemi bazuar në bisedat që kemi patur, raportet
11 që kemi lexuar, dhe nuk mendoj që shumë njerëz apo ndokush ka
12 patur në atë kohë një informacione të plota dhe të tërësishme.

13 Pra, gjërat kanë -- janë zhvilluar pastaj në vijim, në
14 javët në vijim. Dhe unë vazhdoj të them, pra, ne kemi, ne
15 kuptohemi që kemi kuptuar kush janë aktorët më mirë, kemi
16 kuptuar edhe pikën, pikat që z. Kouchner tha më parë, dhe mund
17 të ketë qenë që teknikisht është sugjeruar mënyra se si të
18 ecej më tej, por politikisht ishte ndryshe. Pra, me gjithë, se
19 kjo është tre muaj më vonë, ka patur, kjo ishte kohë e gjatë
20 në krijimin e institucioneve të para në Kosovë dhe
21 informacioni ishte më i tërësishëm dhe i plotë.

22 PY. Faleminderit.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Dokumenti mund të hiqet tani, se
24 është në prova e gjithë parathënia.

25 PY. Dua tani të kalojmë në një temë të fundit lidhur me

1 ligjet të cilat ju përmendët.

2 Z. DIXON: [Përkthim] Dua të shfaqim në ekran, në anën e
3 djathtë të ekranit, deklaratën tuaj, paragrafin 60, 61. Dhe
4 pastaj në anën e majtë të ekranit do të doja të shfaqim
5 DKV1641 deri në 1658.

6 PY. Z. Strohmeyer, ky është raport i raportit të Marc Meller
7 [Sipas përkthimit] të cilin mund, ndoshta e njihni, lidhur me,
8 i cili ka dokumentuar ligjet në Kosovë. Quhet "Krizë në Kosovë
9 1989-1999". Dhe do ju bëj disa pyetje lidhur me të. Shikojmë
10 deklaratën tuaj së pari.

11 Po, ky raporti i profesorit Marc Weller, pastaj deklarata
12 juaj paragrafi 60, 61, në anën e djathtë të ekranit.

13 Z. DIXON: [Përkthim] Kalojmë në fund të paragrafit 61.

14 PY. Këtu ju flisni për hakmarrjen, që përmendet edhe më
15 herët, dhe thoni që:

16 "Kjo mund të shkonte, kjo ishte dhe kundër, që kjo ishte
17 kundër qasjes bazike, thelbësore të rezistencës paqësore që
18 mbrohej nga Rugova dhe mbështetej nga kosovarët."

19 Dhe pastaj thoni:

20 "Në këtë kontekst është shumë e qartë se UÇK-ja kishte
21 një qasje, një qëndrim shumë më agresiv ndaj marrjes së
22 pushtetit në Kosovë dhe kthimi -- dhe bërjes së Kosovës në një
23 Kosovë vetëm për kosovarët, në një vend vetëm për kosovarët."

24 Dhe pastaj në paragrafin 61, ju flisni tani se si UÇK-ja
25 nuk mund të pranonte ligjin e zbatueshëm të cilin ata e

1 shikonin si ligji, e konsideronin si ligji i pushtuesit serb.
2 Në përvojën time shumë ligje penale janë të ngjashme në mos të
3 njëjta, me përjashtim të disa dispozitave kyçe të cilat kanë
4 nevojë të ndryshohen apo të fshihen. Por për UÇK-në ideja e
5 përdorimit të kodit penal ekzistues ishte e papranueshme dhe
6 nuk ishte as temë negociatash.”

7 Më tej, më poshtë:

8 “Sipas tyre, bëhej fjalë për -- që kjo të quhej, që ky të
9 quhej ligji i Kosovës, dhe ishte një çështje shumë e
10 rëndësishme për ta tani.”

11 Nëse marrim këtë parasysh dhe atë që profesori Weller e
12 ka shkruar, nuk e di e njihni ju atë, ai ka punuar si
13 këshilltar ligjor në Kombet e Bashkuara përfshirë në Siri dhe
14 ka punuar dhe si ekspert mediator në Kombet e Bashkuara. E
15 njihni këtë, e dini këtë?

16 PË. Nuk më kujtohet, nuk mendoj që e njoh.

17 PY. Në rregull. Atëherë, kalojmë në faqen PDF 16, në titullin
18 “konstatime thelbësore”. Kjo është pasi që ai ka ekzaminuar,
19 shqyrtuar, disa ligje të zbatueshme në Kosovë.

20 PË. A mund t’ju pyes cila është data e këtij artikulli?

21 PY. Është viti 1999. Ai i referohet disa ligjeve që shkojnë
22 deri në mars të vitit 1999. Pra, “konstatime thelbësore”, pra,
23 mund ta lexoni:

24 “Natyra e veprimit jugosllav serb e drejtpërdrejtë dhe e
25 qartë në Kosovë mbetet, është e pranishme. Gjatë kryerjes së

1 krimeve të rënda kundër njerëzimit në Kroaci, Bosnjë e
2 Hercegovinë, lidhshipi udhëheqës në Beograd është përpjekur
3 që të mbulojë veprimet e tyre në, duke bërë mohime të
4 pabesueshme. Por lidhur me Kosovën shtypja është bërë në
5 mënyrë shumë më zyrtare, dhe me një program legjislativ të
6 mirëfilltë. Serbia kishte vendkrijuar në mënyrë formale dhe me
7 mënyrë të qëllimshme ligje të reja të cilat i nënshtroheshin
8 ligjit kushtetues të Serbisë. Ajo kishte ulur dhe zhvlerësuar
9 pjesën dërrmuese të popullsisë shqiptare në Kosovë nga, i
10 kishte hequr titullin e kombësisë në pakicë, dhe e kishte bërë
11 atë pakicë. Më shumë se, edhe më shumë se kaq, shumë prej
12 praktikave diskriminatore të hapura zbatoheshin në territor,
13 që zbatoheshin në territor, përmbanin akte legjislative
14 formale ...”

15 Dhe ai vazhdon duke thënë, se kjo përfshinte
16 përgjegjësinë ku individët mund të ishin.

17 Dhe në përshkrimin e përgjithshëm aty, lexohet se ai i
18 referohet një numri të vendimeve të marra nga Kombet e
19 Bashkuara dhe raportorët [Sipas përkthimit], Asambleja e
20 Përbashkët e Kombet e Bashkuara, Komisioni për të Drejtave të
21 Njeriut, Komisioni për Konventat dhe Eliminimin dhe
22 Diskriminimin Racial.

23 Tani dua të konstatoj nëse ju ishit më i informuar për
24 atë që ndodhi në Kosovë dhe qëndrimi i Kombeve të Bashkuara,
25 raportuesve specialë, që kishin konstatuar për ligjet që

1 zbatoheshin në Kosovë në atë kohë.

2 PË. Nuk mund të them që kisha njohuri të hollësishme lidhur
3 me këtë, por isha në fillim, kur kam punuar në Bosnjë, isha
4 pjesëtar i stafit të raportuesit special mbi të drejtat e
5 njeriut në ish-Jugosllavi, dhe kemi lexuar copëza të raporteve
6 mbi Kosovën, pjesë të raporteve, sepse ajo monitoronte
7 tërësinë e ish-Jugosllavisë, pra të gjithë territorin e ish-
8 Jugosllavisë dhe jo vetëm Bosnjën. Pra kishim një ide dhe disa
9 njohuri të një niveli të hollësive që z. Weller shpreh në
10 raportin e tij.

11 Megjithatë, pas takimit që kam bërë me z. Thaçi, dhe
12 shpjeguar -- mendoj që kemi patur, shpjegova që kemi patur më
13 duket dy takime, dhe mendoj që në takimin e dytë në fund të
14 takimit përfundimi ishte që -- dhe që na duhej të kishim një
15 tryezë të rrumbullakët, të paktën kështu më kujtohet, pra.
16 Përpara kësaj, gjatë dhe pas kësaj, kam punuar me disa
17 shqiptarë, juristë shqiptarë të Kosovës të cilët kanë
18 transmetuar, më kanë ndihmuar që të kuptoj në mënyrë më të
19 hollësishme.

20 Dhe kjo ishte ajo që përmenda më herët. Kjo çoi, krijoi
21 disa diskutime mes nesh, mes meje dhe si këshilltar ligjor dhe
22 Selisë Qendrore të Kombet e Bashkuara ku mendoj që ne
23 fillimisht kemi trajtuar çështjen e ligjit të zbatueshëm. Ne
24 poshtë -- mendoj që e kam shprehur në deklaratën time,
25 shikonim këtë nga pikëpamja e procedurës penale dhe menduam që

1 duhej të hiqnim dispozitat jo të -- që nuk ishin të
2 zbatueshme, përmes të cilave ligji për të drejtat e njeriut,
3 ligji për -- ligjet, e drejta evropiane për të drejtat e
4 njeriut, e kështu me radhë, duhej t'i integronim ato.

5 Pra, kur e kuptuam më mirë, kuptimin e thellë të
6 diskriminimit, dhe sensin e thellë të diskriminimit në këtë
7 çështje, siç e thashë më parë, njerëzit e kishin të vështirë
8 ta pranonin këtë, dhe pastaj siç e shpjegova dhe siç na u
9 shpjegua neve, kjo çështje ishte e lidhur me statusin e
10 ligjeve dhe bisedat rreth statusit të Kosovës, nëse kjo ishte
11 pjesë e Serbisë apo jo, pra Kosova do ishte akoma pjesë e
12 Serbisë, në mënyrë që ligjet të vazhdonin të zbatoheshin, apo
13 jo, apo që duhet të kishin njëri-tjetrin tërësi ligjesh të
14 reja. Kjo ishte ajo që më kujtohet.

15 PY. Është e saktë, por nuk ishte thjesht UÇK-ja që thoshte që
16 kishte problemin, që ishin problem ligjet e të kaluarës, se
17 kjo ishte histori e pasur e Kombeve të Bashkuara dhe organeve
18 të tyre që ndëshkonin ligjet që ishin, që binin në kundërshtim
19 me këto standardet e të drejtave të njeriut ndërkombëtare, a
20 është kështu apo jo?

21 PË. Po.

22 PY. Dhe me qëllim që të trajtonim këtë situatë, siç thatë më
23 herët, pjesë e saj ishte formulimi i një rregulloreje ku ju
24 thatë ligji zbatohet përpara 24 marsit 1999, por nuk mund të
25 ishte në kundërshtim me standardet e të drejtave njerëzore, të

1 njeriut, ndërkombëtare. Pra, ju keni marrë parasysh se duhej
2 të ndërrohej këtë me qëllim që këto ligje, me qëllim që të
3 ishin në përputhje me standardet në fjalë.

4 PË. Kjo ishte formula, kompromisi që ne arritëm.

5 PY. Pra, morët parasysh faktin që ishte e nevojshme të
6 ndryshohen këto ligje në atë masë që të ishte e duhur për --
7 në mënyrë që ato të ishin në përputhje me direktivat e Kombeve
8 të Bashkuara?

9 PË. Po. Dhe për ta cilësuar këtë ishte kompromis që ne
10 arritëm mes selisë dhe neve në terren që na jepte ne mundësinë
11 për të deklaruar disa ligje të pazbatueshme.

12 PY. Pra, nuk ishte thjesht UÇK-ja që donte emrin kosovar në
13 gjithçka, me përjashtim të atyre që ishin diskriminuese, pra
14 nuk ishte vetëm UÇK-ja, por edhe organet e tjera përfshi
15 Kombet e Bashkuara që thoni që ligji diskriminator nga e
16 kaluara duhej të shfuqizoheshin.

17 PË. Po. Ju po i referoheni deklaratës time në bisedën -- i
18 është bërë e qartë që kjo ishte, është bërë e qartë që kjo
19 është e papranueshme dhe përpiqeshim që të arrinim një
20 kompromis. U përpoqa ta shpjegoj këtë çështjen e statusit dhe
21 çështja e të drejtave të njeriut, ideja ishte që të arrinim në
22 një pikë të ngjashme, por kjo është refuzuar.

23 Dhe nuk më kujtohet, edhe personat e tjerë kanë pas
24 pikëpamjet e tyre. UÇK-ja ishte, këmbëngulte në mënyrë të
25 qartë, z. Thaçi me mua, por edhe UÇK-ja në tërësi, këmbëngulte

1 mbi këtë pikë, u bë pikë qendrore, pra, e angazhimit tonë. E
2 kam fjalën angazhimi jonë i PSSP-së, që ishte përfshirë
3 personalisht në këtë çështje. Kjo u bë, pra, në këtë moment
4 pikë, çështje qendrore. Kjo ishte kryesisht me UÇK-në, dhe
5 kryesisht me UÇK-në, pra, kjo pikë.

6 PY. A jeni në dijeni se z. Rugova, të cilin e përmendët,
7 kishte kërkuar të njëjtën gjë që në 1992, që pra ligji duhej
8 të shfuqizohej, pra nuk ishte vetëm UÇK-ja që e thoshte këtë
9 gjë? Po përpiqem të kuptoj kontekstin e plotë, nuk ishte vetëm
10 UÇK-ja siç përmendët ju, por ishin shumë organe që kërkonin
11 këtë gjë?

12 PË. Unë nuk kam përzgjedhur vetëm UÇK-në, unë po them që unë
13 kam komunikuar me UÇK-në, nuk kam biseduar me z. Rugova. Kam
14 thënë që unë kam kuptuar shumë mirë këtë gjë, dhe më
15 konkretisht pasi biseduam me juristët kosovarë dhe kështu me
16 radhë, dhe nuk e mohoj fare këtë.

17 Por, kjo është në përgjigje të pyetjeve, ishte një
18 shembull tjetër i bisedës ku, në një -- interpretimi i selisë
19 qendrore më shumë se sa i joni, por interpretimi i tyre, ishte
20 se Rezoluta 1244 po kundërshtohej kryesisht dhe konkretisht
21 nga UÇK-ja në mënyrë të qartë. Z. Rugova mund ta ketë thënë të
22 njëjtën gjë më herët, por përshtypja jonë ishte se çështja
23 kyçe e bashkëpunimit tonë dhe -- edhe pranisë tonë në Kosovë,
24 të paktën në pikëpamjen time, ishte UÇK-ja, jo vetëm, por edhe
25 përfaqësuar nga z. Thaçi.

1 Z. DIXON: [Përkthim] A mund të -- që të kuptoj më mirë
2 situatën lidhur me z. Rugova, në qoftë se mund të kalojmë tek
3 dokumenti në formën PDF, 11, është i njëjti dokument që është
4 në ekran, në anën e majtë. Kjo është një letër që i drejtohet
5 komisionierit, Komisionit për Siguri dhe Bashkëpunim në
6 Evropë. Kjo është e majit 1992.

7 Kalojmë faqen dy herë -- dy faqet e tjera dhe shihet që
8 është shkruar nga z. Ibrahim Rugova, organi koordinues i
9 partive politike të Kosovës, Adem Demaçi, kryesues i Këshillit
10 për të Drejtat, Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive
11 në Kosovë, në Prishtinë. Është një faqe pas kësaj ku shihet
12 letra.

13 PY. Përfshihet edhe raporti i profesorit Weller, ku tregohen
14 qëndrimet e të gjitha palëve gjatë kësaj kohe, apo -- është
15 letër dërguar, përfshirë edhe nga z. Ibrahim Rugova. Do të
16 shohim një pjesë të kësaj letre, që është në faqen paraprake.

17 Z. DIXON: [Përkthim] Kthehemi një faqe më parë.

18 PY. Do të lexoj aty:

19 "Menjëherë pas rrënimit të dhunshëm të autonomisë së
20 Kosovës", dhe këtu i referohet vitit 1990, "Serbia filloi me
21 miratimin e një programi -- e programeve edhe ligjeve speciale
22 në Kosovë, me anë të të cilëve diskriminimi dhe aparteidi
23 bëhen institucionalë në nivelin e gjenocidit. Instrumenti i
24 drejtpërdrejtë i funksionalizimit të kësaj ka të bëjë me
25 programin, e ashtuquajtur, të realizimit në republikën -- në

1 provincën autonome socialiste të Kosovës. Ky është publikuar
2 në gazetën më 30 mars 1990.

3 "Programi me këtë titull është program tipik i
4 kolonizimit dhe në përmbajtje dhe në natyrë. Ai parasheh që
5 një numër të caktuar masash konkrete dhe sistematike që
6 ndërmerren nga Serbia në Kosovë kundër shqiptarëve me qëllim
7 që të tjetërsojnë strukturën etnike të popullsisë. Për
8 realizimin e këtij programi, Serbia miratoi një sërë ligjesh
9 ku, antikushtetuese të cilat zbatohen vetëm në Kosovë kundër
10 shqiptarëve"

11 Dhe pastaj renditen, unë nuk do t'i lexoj të gjitha këto.

12 A ishit në dijeni ju të qëndrimit të Rugovës lidhur me
13 ligjet dhe nevojën për t'i shfuqizuar ato?

14 PË. Nuk mendoj që në fillim, nëse më kujtohet saktë, puna për
15 rregulloren numër 1 pas gjashtë javësh, është dashur kohë për
16 ta bërë këtë. Nuk mund të them që nëse gjatë bisedimeve lidhur
17 me rregulloren numër 1, ku jam informuar nga disa juristë
18 lidhur me këtë pikë. Sigurisht që ka qenë, më janë treguar
19 shumë ligje dhe disa nene të, që juristët kosovarë kishin
20 shkruar lidhur, artikuj, juristët kosovarë kishin shkruar me
21 to, pra.

22 Sa më përket mua, kisha ndjenjën që nuk mund të thoja
23 thjesht që ligji që ishte i zbatuar në atë kohë apo jo, më 10
24 qershor, vazhdon të jetë i zbatueshëm. Dhe për rrjedhojë një -
25 - kompromisi që kemi kërkuar dhe kemi gjetur, që jemi

1 përpjekur t'u ofrojmë në mënyrë që kjo do të ishte, do të
2 rishikohej pastaj nga pikëpamja e respektimit të të drejtave
3 të njeriut, dhe pastaj do të na jepte mundësinë ne që të
4 ndanim këto ligje.

5 PY. Po. Mund të themi sot që është bërë kompromis i cili
6 pasqyrohej në këto rregullore, është dhe rast tjetër, pra tani
7 me -- në retrospektivë, ku ju mund të thoni që ishte, ishin
8 disa organizata dhe udhëheqës që po kërkonin që ligjet të
9 ndryshojnë, jo vetëm UÇK-ja. Kjo duhej të ishte pasqyruar në
10 tërësi në deklaratën tuaj si dëshmitar.

11 PË. Po në deklaratën time, i nderuar Avokati, unë po flas për
12 bisedën me z. Thaçi, dhe në qoftë se mund ta shikoj një herë,
13 bëhet fjalë për një kontekst. Këtu është deklarata ku mua më
14 është kërkuar të më kujtohej historia e miratimit të ligjeve,
15 adoptimit të ligjeve, ndërveprimet në Kosovë. Mua m'u bënë
16 pyetje në fakt lidhur me z. Thaçi, a ju kujtohet kjo, a ju
17 kujtohet ajo. Pra, po, në atë rast po u përgjigjem pyetjeve.

18 Dhe në atë kuptim ndoshta kam thënë që më kujtohet që kam
19 patur këto dy takime ku jam treguar me gisht në një farë
20 mënyre, dhe e thashë dje kjo ishte shumë shoqërore si bisedë,
21 nuk do kishte tension. Ishte konstruktive, dhe nuk kam asgjë
22 për të thënë negative lidhur me këto takime. Dhe mund ta
23 shihni në paragrafin në tërësi që edhe, që jam ndier shumë
24 mirë që të bëj edhe pyetje këtyre. Kemi trajtuar disa tema.

25 Për neve ishte shumë e qartë, si UNMIK, dhe kjo ishte

1 arsyjeja për të cilën biseduam me UNMIK-un, dhe kjo ishte e
2 qartë për neve, sepse ai ishte personi që shprehu këtë si një
3 sfidë themelore, si kusht *sine qua non* për, i domosdoshëm për
4 bashkëpunimin tonë për zbatimin e Rregullores 1244, dhe e
5 kuptoj arsyeën pse, jo vetëm përmes kësaj bisede, por edhe
6 shkëmbimet që pastaj kemi patur me të tjerët, që na ka bërë të
7 kuptojmë gjithnjë e më mirë këtë situatë dhe këtë kontekst.
8 Por theksoj që ky ishte një rast tjetër, ku u kundërshtua
9 autoriteti jonë këtu.

10 Ky ishte konteksti, dhe në këtë kontekst e kam dhënë këtë
11 deklaratë. Në atë kohë nuk më është kërkuar, nuk më është --
12 nuk jam pyetur nëse e njihja z. Rugova. Do të isha referuar
13 Rugovës, po të më ishte bërë pyetja. Kështu ka qenë.

14 PY. Po, por këtu keni thënë "ata", përemrin në shumës, s'keni
15 përmendur një emër të përveçëm. Ju thatë ata, UÇK-ja, deshën
16 të vendosnin këtë etiketim të caktuar të Kosovës në këtë ligj.
17 Sidoqoftë, në dëshminë tuaj ju po thoni që s'ka qenë vetëm
18 UÇK-ja, kanë qenë disa, ka qenë një grupim në fakt, përfshirë
19 dhe Kombet e Bashkuara që kanë thënë që ligjet, ligji duhet të
20 ndryshojë dhe ju në fakt e pranoni që ka pas një kompromis.

21 PË. Po. Edhe atëherë, ka pasur, është pranuar gjerësisht,
22 edhe nga perspektiva e ditës së sotme unë pajtohem me këtë,
23 edhe sidoqoftë njeriu mund të ndryshojë ndonjëherë mendimin
24 fillestar që ka pasur.

25 PY. Faleminderit.

1 Z. DIXON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, unë përfundova
2 me pyetje e mia. Ju lutem që të pranohen si pjesë e provave
3 gjyqësore dokumentet që përdora unë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E keni fjalë
5 për analizën?

6 Z. DIXON: [Përkthim] Po, e kam fjalën për analizën e
7 Weller. Bashkë me dokumentin bashkëngjitur, që është shkresa
8 nga z. Rugova. Por do t'ju jap numrin e saktë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kam një
10 dokument që kam marrë shënim me numrin DKV1641, 1658.

11 Z. DIXON: [Përkthim] Po, ky është dokumenti i saktë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] ka
13 kundërshtime?

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
16 DKV1641, 1658, pranohet.

17 Z. DIXON: [Përkthim] Këto ishin pyetjet e mia,
18 faleminderit.

19 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
20 numrin e provës 2D00039, dhe është klasifikuar si publik.
21 Faleminderit.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tully,
23 fjala është për ju.

24 Z. TULLY: [Përkthim] Faleminderit.

25 Pyetje të palës tjetër nga z. Tully:

1 Z. TULLY: [Përkthim]

2 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Se ka kaluar ora 12.00. Unë quhem
3 Eric Tully dhe përfaqësoj z. Rexhep Selimi. Kam disa pyetje,
4 shpresoj që do zgjasi vetëm gjysmë ore.

5 Fillimisht, lexova përvojën që keni pasur ju deri në
6 momentin që i jeni bashkuar UNMIK-ut në 1999, por nëse e
7 kuptoj unë saktë, që ju keni qenë gjykatës në Gjermani dhe
8 deri në momentin që jeni bërë këshilltar juridik në UNMIK, të
9 gjitha këto kanë qenë poste të natyrës juridike, apo jo?

10 PË. Po.

11 PY. Keni punuar ndonjëherë në fushën e zbatimit të ligjit?

12 PË. Si?

13 PY. Pra, me policinë, keni punuar ndonjëherë?

14 PË. Jo.

15 PY. Pra, ju jeni rekrutuar si këshilltar juridik dhe keni
16 ardhur nga tre vite përvojë në Bosnjë.

17 Z. TULLY: [Përkthim] Kjo është e thënë në Shënimin
18 Përgatitor numër 1, paragrafi 18.

19 PY. Dhe ju keni qenë një nga autorët e kodit penal, kodit të
20 procedurës penale dhe e njihni kornizën ligjore të
21 Jugosllavisë, apo jo?

22 PË. Po.

23 PY. Duhet të ngadalësohem, duhet -- se s'dua të zemëroj
24 përkthyesit, duhet të ngadalësoj patjetër.

25 Keni thënë në Shënimin Përgatitor numër 1 se:

1 "Policia ushtarake edhe çështjet e rendit dhe të zbatimit
2 të ligjit, si rregull nuk do të trajtoheshin nga dikush që
3 ishte nën kodin 218", ky ka qenë roli juaj, "por sidoqoftë një
4 gjë e tillë ndodhi".

5 Pra unë kam të drejtë kur them që kjo është -- nuk është
6 e pazakontë sidomos në fillimet kaotike të UNMIK-ut edhe ju
7 kishit një rol, disa detyra, por në fakt nuk e kishit
8 domosdoshmërisht përvojën për të ushtruar nga disa detyrat që
9 keni kryer?

10 PË. Në fakt keni të drejtë ta thoni këtë, por më duhet të
11 shtoj që ekipi në fillimisht ishte i kufizuar, ishim pesë a
12 gjashtë persona, ishte një ekip shumë i vogël. Në rastin tim,
13 mua më bënë pjesë të ekipit për shkak se kisha përvojë
14 juridike, përvojë ligjore. Por sidoqoftë, të gjithë që ishim
15 atje në njëfarë mënyre ishim këshilltarë të SRSG-së, dhe ditët
16 pasuese dhe javët pasuese u bë një strukturim më i plotë sa i
17 takon pozicioneve të UNMIK-ut. Nuk kishim organigramë, kështu
18 që fillimisht asnjë prej nesh nuk kishte një rol konkret të
19 një organigrame, të gjithë kishim përvoja të ndryshme, por që
20 ishim këshilltarë në SRSG.

21 PY. Pra, ju -- më falni për këtë krahasimin që do bëj, por ju
22 ishit si këto ushtritë zviceriane [Sipas përkthimit], në një
23 farë mënyre. Edhe ju bënit disa detyra që në fakt nuk ishin
24 pjesë e përshkrimit të punës suaj, apo jo?

25 PË. Po.

1 PY. Tani dua të flas për kontaktet që keni pasur me z. Selimi
2 dhe di -- sa dijeni keni pasur për z. Selimi.

3 Z. TULLY: [Përkthim] Për këtë do kërkoja që të vendoset
4 në ekran materiali që mban numrin P01968. Do të doja të
5 shikoja paragrafin 24 dhe 25, edhe përbri, ju lutem, nxirrni
6 Shënimin Përgatitor numër 2, që mban numrin 124648 deri në
7 124653. Faleminderit.

8 PY. Ndërkohë që presim Shënimin Përgatitor numër 2, mund të
9 fillojmë. Ju e keni përmendur dy herë z. Selimi në deklaratën
10 tuaj. Në paragrafin 24, keni thënë mbërritjen e një limuzine
11 të zezë, dhe keni thënë:

12 "Mund të kem parë dhe një person tjetër atje, që mund të
13 ketë qenë Rexhep Selimi."

14 Por nuk jeni i sigurt?

15 PË. Jo, nuk jam.

16 PY. Edhe e keni përmendur edhe paragrafin 25, dhe keni thënë
17 në këtë paragraf:

18 "Ndër pjesëmarrësit në takim ishin Hashim Thaçi dhe
19 Rexhep Selimi."

20 Pra, a kam të drejtë kur them unë që jeni më i sigurt për
21 takimin e dytë?

22 PË. Jam më i sigurt se e kam parë në takimin e dytë, por jo
23 100 për qind. Këtë kam thënë.

24 PY. Në rregull. Dhe ta theksoj edhe një herë, në Shënimin --
25 13, te Shënimi Përgatitor numër 1, ju keni thënë se nuk ju

1 kujtohet çfarë roli ka pasur z. Selimi në atë kohë, apo nëse
2 është prezantuar?

3 PË. Mbase edhe e kam ditur, por tani nuk më kujtohet.

4 Z. TULLY: [Përkthim] Atëherë, vendosim në ekran
5 materialin që mban numrin P01169, edhe tek Shënimi Përgatitor
6 numër 2, të shohim paragrafin 9. Faleminderit.

7 PY. Në Shënimin Përgatitor 2 ju keni thënë që nuk e keni
8 njohur të riun që është në fotografi, që është personi në të
9 djathtë të fotografisë. Këtë Prokurori -- më falni, këtë
10 fotografi ua ka treguar Prokuroria javën e kaluar.

11 PË. Saktë.

12 PY. Dhe po ashtu i keni thënë Prokurorisë se nuk ju kujtohet
13 ndonjë incident konkret apo ndonjë ngjarje konkrete ku të jetë
14 përfshirë Rexhep Selimi, saktë?

15 PË. Sot nuk më kujtohet diçka e tillë.

16 PY. Mirë. Flasim tani për temën kryesore. Është më shumë e
17 natyrës ligjore.

18 Z. TULLY: [Përkthim] Le ta heqim fotografinë nga ekrani,
19 dhe nxjerrim sërish deklaratën e dëshmitarit në paragrafin 33.

20 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Ju lutem, na thoni edhe
21 faqen.

22 Z. TULLY: [Përkthim] Faqja 9, paragrafi 33. Përndryshe,
23 është dokumenti P01968.

24 PY. Dëshmitar, unë dua të trajtoj tani me ju kornizën ligjore
25 për ndalimet që ka kryer KFOR-i asaj kohe. Ju e përmendët

1 shkurtimisht rezistencën e KFOR-it, për të ushtruar detyra që
2 lidheshin me rendin dhe sigurinë publike në atë kohë.

3 Duke marrë parasysh situatën mes UNMIK-ut dhe KFOR-it, sa
4 kohë u desh për KFOR-in që të kryente detyrat për -- që
5 lidheshin me ushtrimin e të drejtës civile, pra me sa ju
6 kujtohet ju, sa kohë iu desh KFOR-it që të ushtronte këto
7 detyra?

8 PË. Nuk mendoj që po i ushtronin të gjitha funksionet në vend
9 të UNMIK-ut, por ato kryenin arrestime, unë nuk do ta thoja që
10 ka pasur luftë mes nesh, ka pasur një mosmarrëveshje mes nesh.
11 Dhe nuk më kujtohet a ka ndodhur javën e parë apo javën e
12 dytë, por një problematikë doli shumë shpejt, dhe pritej që ne
13 të gjenim zgjidhjen për këtë situatë, sepse KFOR-i thoshte nuk
14 është mandati ynë. Gjykonin që nuk ishte mandati i tyre, që të
15 ushtronin detyrat e rendit publik. Mendonin se kjo ishte një
16 fushë më vete, rendi dhe siguria publike, patrullimet,
17 ndalimet, arrestimet, po edhe një farë gjykimi të personave.

18 Ka pasur pra një diskutim të kësaj natyre që kulmoi pas
19 disa javësh në një marrëveshje që besoj se u bë mes SRSG-së
20 dhe Gjeneralit Jackson. Dhe u ra dakord që unë edhe
21 këshilltarët juridikë të KFOR-it të uleshin bashkë, dhe të
22 gjenim një zgjidhje çfarë mund të bënim, afatet kohore.
23 Përgatitëm një dokument.

24 Dhe më duket se pas kësaj u bë disi më e qartë situata,
25 dhe KFOR-i e kuptoi që të duhet t'i ushtronte për një periudhë

1 më të gjatë detyrat, derisa të merrnim ne përsipër. Nuk besoj
2 se ishin shumë të kënaqur me këtë, por sidoqoftë ranë dakord.

3 Përpara kësaj kishim diskutime të përditshme, thoshin
4 "kur do jeni gati, kur do vijë personeli juaj, kur do i kryeni
5 detyrat?". Pra, dy probleme që më kujtohen mua, ka qenë një,
6 jo vetëm për ndalimet, por çfarë të bëjmë me personat që do
7 ndalojmë. Çfarë procesi ligjor do ndjekim për t'i mbajtur këta
8 persona të ndaluar. Dhe problematika e dytë, pa e thënë në
9 terma të përgjithshme kjo, ishte prania e KFOR-it për të
10 ushtruar detyrat e rendit publik, të patrullonin, të siguronin
11 rendin dhe sigurinë publike.

12 Dhe kishim diskutime për praktikat e ndryshme që
13 ndiqeshin ose ndarjet e procedurat e punës. Më kujtohet që ne
14 nga Prishtinë ishim më të pranishëm sesa, e ndërsa forcat
15 britanike ishin forcat që kryenin më shumë patrullim, siç na e
16 shpjegoi Gjenerali Jackson. Këta e bënë për shkak të përvojës
17 që kishin në Irlandën e Veriut, ishin më të njohur me situata
18 të tilla krahasuar me forcat e tjera. Pra, mendoj që këto
19 ishin dy problematikat kryesore që i kishim ne me rendin dhe
20 sigurinë publike.

21 PY. E kuptoj që është një spektër i gjerë, por mua më
22 intereson veçanërisht arrestimi, ndalimi edhe gjykimi në një
23 farë forme i KFOR-it, që kryente KFOR-i. Ju lutem kini këtë
24 parasysh kur të jepni përgjigje në mënyrë që të përfundojmë sa
25 më shpejt.

1 Diskutimi -- në fakt me përgjigjen që dhatë iu përgjigjët
2 dy a tri pyetjeve të miat. Diskutimi që keni pasur me
3 këshilltarët juridikë të KFOR-it, nëse ata mendonin që nuk
4 ishin në Kosovë për të kryer detyra të rendit dhe sigurisë
5 publike, dhe në fakt UNMIK-u ishte përgjegjës për këtë, ata
6 ishin të pakënaqur, por ama vazhduan t'i kryenin këto detyra.
7 Me sa duket, ju arritët t'i bindnit ata që të vazhdonin t'i
8 kryenin detyrat. Mua më intereson mbi ç'bazë ligjore, mbi
9 ç'kornizë ligjore i lejuat ju ata të vazhdonin të ndalonin, të
10 arrestonin dhe të gjykonin personat e ndaluar?

11 PË. Ne në fakt u përpoqëm të përdornim shumë bazë, si bazë,
12 Rezolutën 1244, dhe dy paragrafë kryesorë që lidheshin me
13 mandatet, më duket se për KFOR-in ka qenë paragrafi 9, dhe për
14 ne ishte paragrafi 11. Me sa më kujtohet mua, paragrafi 9
15 ishte një lloj klauzole që thoshte që duhet të ofrohet siguri
16 deri në momentin që merr përsipër UNMIK-u. "Derisa", ishte një
17 term.

18 PY. Po, thotë, "të garantohet rendi dhe siguria publike
19 derisa të merret përsipër nga Kombet e Bashkuara".

20 PË. Pikërisht, ne përdorëm këtë lidhëzën, këtë ndajfoljen
21 pikërisht, veçanërisht, për të lejuar për të dhënë bazën për
22 ushtrimin e detyrave të tyre. Në realitet u pëlqente a s'u
23 pëlqente, ata do të duhet ta vazhdonin ta bënë derisa ta
24 merrnim ne përsipër.

25 PY. Në rregull. Kjo ishte në terma të përgjithshëm. Por

1 fokusohemi pak në deklaratën tuaj, në paragrafin 33. Ku ju
2 thoni, drejt fundit të paragrafit:

3 "Pas 4 vitesh, pas kaq vitesh e kuptoj shumë mirë pse e
4 kishte këtë qëndrim COMKFOR-i. KFOR-i as nuk kishte krijuar,
5 dhe as nuk kishte rregulla në fuqi për të qenë një forcë e
6 zbatimit të ligjit."

7 Unë e kuptoj që ju nuk e njihni KFOR-in, por keni përvojë
8 në fushën e Kombeve të Bashkuara. Unë dua të më shpjegoni,
9 rregullorja e procedurës, çfarë rëndësie ka? Dhe sa e
10 rëndësishme ishte kjo për KFOR-in që të ushtronte detyrat e
11 një force policore?

12 PË. Që ta shpjegoj dhe një herë, është çështje interpretimi.
13 Ne donim që ata të kryenin patrulla. Sigurisht që sipas
14 rregullores së procedurës, kishte, jepeshin hapësira për forca
15 të caktuar brendapërbrenda KFOR-it që të ushtronin disa nga
16 detyrat. Por, sidoqoftë, shumë nga këto forca -- dhe unë tani,
17 në fakt i kuptoj më mirë tani, pas kaq vitesh e kuptoj më mirë
18 pse hezitonin forcat policore.

19 Kam folur me oficerët, me personelin. Flas personelin
20 ushtarak që ka qenë në Haiti, edhe e përmenda që kam folur dhe
21 me avokatët e INTERFET edhe personelin në Timorin Lindor.
22 Domethënë, dua të them që situata është e ngjashme. Nuk duan
23 të përfshihen kryesisht në rendin dhe sigurinë publike. Filloi
24 me çështjen e patrullimit, pra fillon me patrullim, por ama
25 përfundon pastaj me procese gjyqësore, një situatë e tillë.

1 PY. Në rregull.

2 Z. TULLY: [Përkthim] I lutem Sekretarit të seancës të
3 vendosë në ekran materialin që mban numrin DRS0125-DRS1267,
4 dhe jo për publikun, ju lutem.

5 PY. Do ju tregoj rregulloren e procedurës së UNMIK-ut, që
6 është hartuar më pas dhe ku referohen dhe komponentët e
7 policisë që kishte UNMIK-u. Dhe sipas meje, ka diçka që ka
8 munguar. Mund ta shohim bashkë tekstin, dhe më thoni nëse
9 vërtet mungon diçka nga rregulla e procedurës, rregullorja e
10 procedurës së KFOR-it, edhe ma thoni nëse pajtoheni me mua.
11 Nëse nuk keni diçka për të thënë, atëherë thoni që nuk kam
12 diçka për të thënë.

13 PË. Mund ta bëjmë këtë gjë, por sidoqoftë, unë nuk kam qenë i
14 përfshirë drejtpërdrejt në rregulloren e procedurës së UNMIK-
15 ut për krijimin e forcës policore.

16 PY. Nuk ka problem, ne e shohim së bashku dhe pastaj më jepni
17 përgjigjen tuaj.

18 Z. TULLY: [Përkthim] Shohim paragrafin 3.

19 PY. Më intereson këtu, rregullorja është bazë e fortë
20 ligjore. Dhe thotë, dokumenti parasheh autoritetin, apo
21 kompetencat, "për përdorimin e forcës dhe shpjegon politikën,
22 parimet, përgjegjësitë dhe përkufizimet e rregullores".

23 Unë nuk e kam vetëm për fjalën e një rregullore të UNMIK-
24 ut, por rregulloret e Kombeve të Bashkuara janë baza ligjore,
25 janë Bibla për të trajtuar, dhe ku përcaktohen të gjithë

1 parametrat, për ushtrimin e një detyre. A e kuptoni edhe ju
2 kështu?

3 PË. Po.

4 PY. Në paragrafin e radhës thotë kështu:

5 "Kanë dalë si ndalesa, janë urdhra për të mos marrë
6 veprime specifike. Kur janë nxjerrë si leje, atëherë janë
7 kompetenca për komisionerin e policisë dhe komandantët e
8 policisë të ndërmarrin disa masa konkrete nëse gjykohen të
9 nevojshme për të përmbushur synimin e misionit."

10 Atëherë, sipas jush, të paktën siç e kuptoj unë, janë
11 ndërmarrë veprime atëherë që nuk kanë qenë të parapara në
12 rregulloren e procedurës, dhe janë marrë pa pasur kompetencat
13 juridike? Për policinë e keni fjalën?

14 PË. Po.

15 PY. Atëherë, është çështje terminologjie, por e kuptoni edhe
16 ju këtë që kështu duhet të funksiononte rregullorja edhe për
17 KFOR-in?

18 PË. Kështu e kuptoj edhe unë, po.

19 Z. TULLY: [Përkthim] Shohim faqen 10 të të njëjtit
20 dokument. DRS01261.

21 PY. Po kjo, dhe kjo është rregullorja. Nuk më intereson se si
22 është hartuar.

23 PË. E keni fjalën për rregulloren e UNMIK-ut?

24 PY. Po, është rregullorja e UNMIK-ut, po e përdor thjesht si
25 referencë, për krahasim. Për shembull, këtu mund të shohim

1 rregullat e ndryshme. Mund t'i lexoni vetë rregullat që janë
2 në këtë dokument. Por mua më intereson tek 4(1)(c):

3 "Ndalimi i çdo personi autorizohet për qëllimet më
4 poshtë:"

5 Dhe te pika (c) thotë:

6 "Që personi të paraqitet përpara një gjykate apo
7 autoriteti ligjor kompetent, për të shqyrtuar akuzat që janë
8 ngritur kundër tij, apo kundër saj."

9 Dhe 4(2) thotë:

10 "Ndalimi i individëve apo grupeve me rast -- me
11 përjashtim të rasteve që janë paraparë në procedurën në fjalë,
12 janë të ndaluara, është e ndaluar."

13 E lexuat?

14 PË. Po.

15 PY. Mbase ju nuk e dini me hollësi, por kur KFOR-i e ngriti
16 problematikën dhe tha që "shiko se rregullorja jonë nuk e
17 lejon që ne të kryejmë detyra të rendit dhe sigurisë publike",
18 ishte pikërisht për faktin se kjo rregull mungonte në
19 rregulloren e tyre, apo jo?

20 PË. Tani sa i takon kësaj bisedës që kemi pasur me juristët e
21 KFOR-it, dhe me Gjeneralin Jackson apo me këdo person tjetër,
22 problemi kryesor dhe i parë ka qenë fakti që ishte një
23 rezolutë, sipas tyre nuk ishte detyra e KFOR-it, por ishte
24 detyra e jonë. Rregullorja nuk është diskutuar shumë. Ne
25 thjesht po përpiqeshim të reagonim, ose po përpiqeshim të

1 gjenim një ekuilibër të pushteteve, ne nga Prishtina, apo për
2 të trajtuar ngjarjet dhe ne mendonim që ishte e nevojshme të
3 kishte prani të personave në rrugë. Ata sigurisht që e
4 respektuan më pas këtë, por nuk është e njëjta praktikë në çdo
5 AOR. Pra, rregullorja nuk u diskutua nga pikëpamja e ndalimit
6 të personave, por ata hezitonin që të kishin prani policore në
7 rrugë apo patrulla në rrugë. Domethënë, çështja ishte sepse
8 ata mund të ishin në ambientet ku qëndronin, dhe herë pas here
9 mund të shfaqeshin dhe të paraqiteshin në rrugë.

10 PY. Mirë, atëherë shohim deklaratën tuaj.

11 Z. TULLY: [Përkthim] Ju lutem vendosni në ekran
12 deklaratën e dëshmitarit tek paragrafi 42. Faleminderit.

13 PY. Ju keni thënë gjatë kohës që kryheshin arrestimet në fakt
14 pati problematika. Do t'ju lexoj një pjesë të deklaratës ku ke
15 thënë që:

16 "Pati një sens në rritje të frustrimit. Për shembull,
17 Zyra për Çështjet e Gjyqësorit nuk kishte personel me kohë të
18 plotë deri në mes të korrikut dhe po kryenin disa funksione
19 bazike të gjyqësorit, për të pasur procese të rregullta
20 ligjore për personat që kishin ndaluar trupat e KFOR-it dhe që
21 mbaheshin përkohësisht në godinat e KFOR-it.

22 Pra, a ju kujtohet që kur pamë bashkë rregulloren e
23 UNMIK-ut, aty kishte dispozitë specifike për një person që
24 duhet të dalë përpara autoritetit kompetent edhe që një person
25 nuk duhet të ndalohej me përjashtim të rasteve që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Hansjoerg Strohmeyer (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Tully

Faqe 92

1 evidentoheshin në këtë rregullore. Por dhe ju keni thënë që në
2 fakt ju keni pasur vërtet problematika me këto procesin e
3 rregullt ligjor dhe me arrestimet e KFOR-it. A më kuptoni?

4 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kundërshtoj.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

6 DËSHMITARI: [Përkthim] Që ta sqarojmë një herë.

7 Rregullorja e UNMIK-ut është hartuar goxha më pas. Nuk kanë
8 qenë në fuqi, në kohën që po flas, për të cilën po flas unë.
9 Kur kam qenë unë atje i pranishëm nuk kemi pasur as forcë
10 policore dhe as nuk kemi pasur rregullore ne si UNMIK. Për ne,
11 ishte KFOR-i autoriteti që i kryente arrestimet në bazë të
12 rregullores së tyr, edhe filluan të na nxisnin ne që t'i
13 kryenim më pas, që të krijohej një formë, një gjykatë, një
14 institucion i ngjashëm me gjykatën në mënyrë që ta hetonim
15 këtë situatë sepse situata është disi emergjente.

16 Z. TULLY: [Përkthim]

17 PY. Që ta bëj të qartë, unë nuk po bëj supozime, e di që
18 s'mund të flasim gjatë e gjerë për rregulloren. Por unë dua të
19 flasim për faktin që ju keni dashur të garantoni procese
20 ligjore aq sa të mundnit. Dhe KFOR-i, në misionin e vet, nuk
21 ishte një forcë policore, nuk ishte një forcë që kryente
22 rendin dhe sigurinë publike. Dhe as nuk priste që ta kryente
23 diçka të tillë. Kjo ka qenë diçka që më pas do ta kryente
24 UNMIK-u me forcën e vet policore.

25 PË. Nuk e kuptoj tërësisht këtë që po më shpjegoni ju, por me

1 sa kam kuptuar unë në atë kohë, dhe siç e kuptoj sot,
2 sigurisht që për çdo forcë, çdo organizatë duhet të ketë një
3 rregullore procedure, apo rregullore operacionale. Kështu që
4 unë besoj që edhe KFOR-i një rregullore e kishte.

5 Ajo që nuk më kujtohet mua konkretisht është pikërisht
6 kjo që nuk më kujtohet që të kemi bërë diskutime ne, analizë
7 juridike që këtë e thotë rregullorja juaj, dhe këtë e thotë
8 rregullorja jonë. Por mbaj mend që kemi diskutuar kështu, kjo,
9 ata thonin, kjo është detyra juaj, kjo nuk është detyra jonë.
10 Pra, problematika kryesore është, a do ta ushtronin ata këtë
11 funksion, kjo ka qenë natyra e diskutimeve me sa më kujtohet
12 mua sot.

13 PY. Kur thatë që juve jeni përpjekur që të mund të jepni disa
14 masa të procesit të rregullt ligjor për individët, cilat kanë
15 qenë disa prej masave të cilat ose disa prej shqetësimeve
16 kryesore që kishin të bënin me procesin e rregullt ligjor për
17 individët në ndalim?

18 PË. Së pari kishte presion nga gjykatat, nga COMKFOR-i që
19 prej fillimi, dhe shqetësimi nuk kishte të bënte konkretisht
20 me dispozita të caktuara, por kishte të bënte me faktin që
21 gjykimi bëhej, duhej të bëhej nga një gjykatë civile dhe jo të
22 ishte pjesë e përgjegjësisë ushtarake.

23 Me aq sa më kujtohet, por edhe pasi kam parë të gjitha
24 dokumentet dhe kam lexuar dokumentin për përgatitjen për këtë
25 seancë, e kuptoj tani që ndonjëherë ata kanë qëndruar në tenda

1 ose kanë qenë të ruajtur, kështu që me fjalë të tjera,
2 domethënë, në përgjithësi kishte një lloj shqetësimi që kishte
3 të bënte me faktin për të trajtuar situatën, ndërkohë që ne në
4 atë situatë nuk është se i kishim kapacitetet për të drejtuar
5 këto zhvillime.

6 Sa i takon procesit të rregullt ligjor, ne ishim të
7 shqetësuar kryesisht, domethënë, për këto, periudhën për t'u
8 mbajtur për një periudhë tre-katër ditë, ose të drejtën për
9 t'u dëgjuar.

10 PY. Po për të drejtën për të apeluar?

11 PË. Po, edhe të drejtën për të apeluar. Po, domethënë, me
12 fjalë të tjera të drejtën për të dhënë argumentet juridike nga
13 ana e palës së ndaluar. Pra, zakonisht këto ishin çështje të
14 cilat kishin të bënin me paraburgimin, me çështjet e
15 parburgimit ose me aspektet të cilat janë të zakonshme në
16 pjesën më të madhe të vendeve.

17 PY. Nuk dua të jem kritik, nuk është se e kam në formë
18 kritike, por si rezultat i situatës, domethënë, duket që
19 situata ka qenë e vështirë. Megjithatë, sa i takon procesit të
20 rregullt ligjor, a mendoni që ia kemi dalë, ose keni qenë të
21 suksesshëm për procesin e rregullt ligjor?

22 PË. Për këtë arsye përmenda "masën", sepse ndoshta situata ka
23 qenë shumë komplekse dhe nuk është se e kam kuptuar situatën
24 atëherë aq mirë sa e kuptoj sot, në retrospektivë. Megjithatë,
25 ne supozonim që duke krijuar këtë trup gjykues, këtë panel,

1 mendonim që të organizonim, që të kishim një strukturë, një
2 organizatë që të mund të trajtonte aspektet më të zakonshme,
3 në mënyrë të tillë që njerëzit të mos kishin ndjesinë që
4 thjesht po merreshin, po ndaloheshin dhe thjesht nuk kishin
5 absolutisht asnjë të drejtë për sa i takon pretendimeve të
6 tyre. Megjithatë, në atë kohë nuk besoj që ne i kemi mbuluar
7 mjaftueshëm të gjitha këto aspekte. Pra, ne nuk është se kemi
8 krijuar të gjitha hapat e mundshme ose strukturat e mundshme
9 që të ishin të ngjashëm me strukturat që ne kishim në vendet
10 nga ku vinim.

11 PY. Domethënë, në përmbledhje, jeni përpjekur, por nuk është
12 se ia keni arritur?

13 PË. Ne u përpoqëm me atë tonën, bëmë më të mirën, aq mund të
14 bënim në kushtet përkatëse. Mund të ketë pasur juristë, ose
15 ekspertë të tjerë që mbase mund të ishin sjellë ndryshe. Ose
16 ndoshta që mund të kishin ushtruar trysni për të prezantuar
17 masa të tjera, ose të kishin bërë struktura të tjera.

18 Megjithëse, kaq patëm mundësi ne të bënim, duke pasur parasysh
19 shpejtësinë me të cilën mund të funksiononim, në mënyrë të
20 tillë që të mund të drejtonim aspektet më të rëndësishme dhe
21 në mënyrë të tillë që të ecnim drejt një sistemi gjyqësor më
22 funksional.

23 PY. Kam dhe disa pyetje të tjera për ju. A keni dëgjuar ose a
24 keni marrë informacion për sa i takon këshilltarëve juridikë
25 të KFOR-it, që trupat vetë nuk ishin të qartë sa i takon bazës

1 ligjore, mbështetur në të cilat ata mund të funksiononin?

2 PË. Nuk dua të citoj fjalë në gojën e askujt, megjithatë
3 ndjesia e përgjithshme ishte që ka pasur diskutime lidhur me
4 mënyrën e ndryshime të të kuptuarit të kontributeve të trupave
5 dhe të kontingjenteve sa i takon mandatit të tyre mbështetur
6 në rregulloren e funksionimit.

7 PY. Në rregull.

8 Z. TULLY: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarisë të paraqesë
9 në ekran dokumentin SPOE00217919, deri në 0 -- jo, ju kërkoj
10 ndjesë, do e them nga fillimi. 00218047. Faqja për të cilën
11 jam i interesuar është 218043.

12 PY. Janë raporte të ndryshme që janë mbledhur nga vetë
13 [REDAKTUAR]. Të presim sa të shfaqet në ekran.

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do ju kërkoj që të kalojmë në
15 seancë private.

16 Z. TULLY: [Përkthim] Po, ju kërkoj ndjesë, nuk jua
17 kërkoja këtë më herët. Të kalojmë në seancë private.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të kalojmë
19 në seancë private, z. Sekretar.

20 [Seancë private]

21 [Seancë private teksti i fshirë]

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

24 ta ndiqte, të hynte autokolona. Edhe vetë autokolona nga
25 Shkupi drejt Prishtinës nuk e përjashtonte dot mundësinë që

1 nuk do të kishte ndonjë sulm. Unë nuk po them që mund ta
2 kishte bërë këtë domosdoshmërisht Armata Jugosllave. Po ne
3 shihnim shumë njerëz, mbase këta ishin të popullatës kosovare
4 që ishin në rrugë edhe ne kemi hyrë shumë ngadalë drejt
5 Prishtinës sepse po sigurohej parametri [Sipas përkthimit].

6 Po veçanërisht ditët e para kështu më kujtohet. Por nuk e
7 përjashtonim, pra, mundësinë që të mund të kishte ende disa
8 sulme që mund të vinin nga pala serbe.

9 Dhe më kujtohet një incident tjetër, datën s'ua them dot,
10 po mesa kujtoj unë, ka qenë ditët e para kur kam shkuar në
11 shtëpinë në Kodrën e Diellit, papritmas pati të shtëna me armë
12 përpara shtëpisë sonë. Dhe mbaj mend që ose forcat e KFOR-it
13 ose të NATO-s shkëmbyen zjarr me forcat serbe që ishin nga ana
14 tjetër e Kodrës së Diellit. Dhe kjo më kujtohet.

15 Pra, po përpiqem të tregoj që nuk ishte një shqetësim i
16 vazhdueshëm, por, ekzistonte shqetësimi që mund të kishte
17 xhepa të caktuar, sidomos ditët e para, sepse serbët kanë qenë
18 të pranishëm dhe mund të kishin mbetur elementë të Armatës
19 Jugosllave. Ekzistonte gjithmonë frika se mund të kishte ende
20 ndonjë sulm.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe një pyetje përpara
22 pushimit. Më intereson si ka qenë situata kur jeni larguar nga
23 Kosova. Jeni larguar -- kur keni -- kur keni kur ju, situata
24 ka qenë stabël, ka qenë e qetë?

25 PË. Tani varet si e përkufizon "stabël, e qëndrueshme dhe e

1 qetë". Nuk -- nuk mund të them që ika nga Kosova edhe gjërat
2 patën ndonjë përmirësim të ndjeshëm. Sigurisht kishte
3 incidente dhe më pas kemi marrë raporte ngjarjesh. Nuk po them
4 që ishte e shkëlqyer.

5 Por, isha disi i lehtësuar sepse ndaj nesh kishte shumë
6 presion dhe pas pothuajse 3 vjetësh në Bosnje unë mendova që
7 nuk mund të jetoja më dot në një mjedis të tillë ku dita-ditës
8 mund të përballëshe me situata të këtij lloji.

9 Pra, nuk do ta përshkruaja si një situatë të qëndrueshme
10 apo të qetë me pak fjalë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë. Bëjmë
12 dhjetë minuta pushim edhe kthehemi edhe përfundojmë në orën
13 4.30.

14 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë dhjetë
16 minuta pushim.

17 --- Seanca ndërpritet në orën 15.31

18 --- Seanca rifillon në orën 15.41

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
20 Asistentes ta sjellë dëshmitarin në sallë.

21 [Dëshmitari vijon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z.
23 Strohmeyer, do të vazhdojmë me pyetjet e Gjykatësit Barthe.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
25 Smith.

1 Mirë se u kthyet, Dëshmitar.

2 Tani dëshiroj të flasim për takimin që keni pasur me
3 përfaqësues të UÇK-së në veçanti takime që keni pasur me z.
4 Thaçi dhe z. Selimi. Dhe unë do t'ju bëj këto pyetje.

5 Mbrojtja e Thaçit ju tregoi një dokument nga Rambujeja sa
6 ai takon krijimit të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës ku LDK-
7 ja, përkatësisht z. Rugova dhe një parti tjetër LBD-ja u
8 përmendën në atë dokument. Dhe sa për referencë kjo përmendet
9 në provën 1D69.

10 A ju kujtohet që ta keni diskutuar këtë dokument me
11 Mbrojtjen e z. Thaçi apo dëshironi që ta shikoni edhe një
12 herë?

13 PË. Jo, më kujtohet. E kujtoj që kam diskutuar dje.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk doni që ta shikoni edhe
15 një herë këtë dokument, apo jo?

16 PË. Varet se çfarë pyetje do më bëni.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Do ju bëj pyetjen atëherë,
18 pastaj mund të vendosni në qoftë se doni ta shihni apo jo
19 dokumentin.

20 Do t'ju bëj këtë pyetje lidhur me këtë dokument: A jeni
21 takuar ju personalisht me anëtarë të Qeverisë së Përkohshme të
22 cilët në kohën e takimit nuk kanë qenë anëtarë ose përfaqësues
23 të UÇK-së, apo anëtarë të LDK-së, të LBD-së edhe që kanë folur
24 në emër të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës.

25 PË. Që ta kuptoj drejt, po thoni në qoftë se jam takuar me

1 anëtarë që kanë pretenduar që ishin anëtarë të Qeverisë së
2 Përkohshme të Kosovës, por që nuk ishin nga UÇK-ja, këtë po
3 thoni?

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Të UÇK-së dhe folën në emër
5 të Qeverisë së Përkohshme, veçanërisht anëtarë të LDK-së dhe
6 LBD-së.

7 PË. Jo. Gjithsesi, UÇK-ja u mundua që ta ndiqte këtë çështje
8 pak më me shumë seriozitet me neve, sesa të tjerët. Po
9 sigurisht që ka pasur deklarata shumëpartiake e kështu me
10 radhë.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

12 PË. Më lejoni të shtoj diçka tjetër lidhur me këtë aspekt.
13 Ajo çfarë më la përshtypje dje, më bëri përshtypje dje, ka të
14 bëjë kam përshtypjen me 23 shkurtin. Për ne nuk ka pasur
15 vazhdimësi nga Rambujeja që ka çuar në 1244 dhe më tej, sepse
16 për ne Rezoluta 1244 ka ndryshuar të tërë lojën, pra. Ka
17 ndryshuar të gjithë situatën. Në qoftë se shtetet anëtare do
18 kishin dashur që vendimi i Rambujesë të bëhej realitet, pra,
19 të bëhej i prekshëm, atëherë ata do duhej që të kishin hartuar
20 një rezolutë të ndryshme nga ajo që ata miratuan. Kështu që,
21 domethënë, në rastin -- ashtu siç ka ndodhur, për shembull, në
22 Afganistan ose gjetkë, do ishte dashur që të miratohej krijimi
23 i një qeverie të përkohshme për Kosovën dhe do të projektohej
24 të mandatohej roli i Kombeve të Bashkuara që e mbështeste një
25 mision ndihme për këtë Qeveri të Përkohshme.

1 Por siç e dimë të gjithë nuk ka ndodhur kështu; nuk ka
2 qenë kjo situata dhe kjo në vetvete ka sinjalizuar ose të
3 paktën pesë anëtarë të përhershëm të Këshillit të Sigurimit.
4 Pra, ka pasur një mungesë vijimesie të besimit që ka ekzistuar
5 më 23 shkurt, krahasimisht me besimin që ka ekzistuar më 9 dhe
6 me 10 qershor kur është miratuar Rezoluta 1244. Ose në të
7 kundërtën do kishte pasur një rezolutë tjetër tërësisht.

8 Pra, po përpiqem që të them me fjalë të tjera që u mor
9 vendimi që të mos ishte Qeveria e Përkohshme e Kosovës
10 përgjegjëse, por mendimi ishte që Kombet e Bashkuara do mund
11 të ofronin një administratë ekzekutive në mënyrë të tillë që
12 të mund të krijohet një administratë më shumëpartiake ose më
13 shumëpalëshe. Pra, ky është mesazhi kryesor që marr unë prej
14 këtij dokumenti.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në paragrafin 25 të
16 deklaratës tuaj ju përmendi një takim midis jush dhe Hashim
17 Thaçit dhe Rexhep Selimit, një takim i cili ka ndodhur brenda
18 javës së parë që ju keni mbërritur në Kosovë ku z. Thaçi ju ka
19 prezantuar një organigramë ose strukturë ku përshkruante
20 Qeverinë e Përkohshme të Kosovës.

21 Ju më tej thoni që z. De Mello i ka kujtuar z. Thaçi që
22 sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të
23 Bashkuara, UNMIK-u ishte organi ligjor përgjegjës për
24 administrimin e funksioneve qeveritare në Kosovë.

25 A ju kujtohet ta keni diskutuar këtë çështje me

1 Prokurorinë dje?

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Edhe dje?

4 PË. Po.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Jam në dijeni, z. Strohmeier
6 që në seancën përgatitore me ZPS-në edhe dje ju thatë që nuk
7 ju kujtohet hollësi të tjera të bisedës që ka ndodhur në këtë
8 takim, as me z. Mello as me z. Thaçi. Tani dua t'ju pyes edhe
9 një herë tjetër: A ju kujtohet që të ketë thënë ndonjë gjë
10 tjetër z. Thaçi për të komentuar atë çfarë tha z. De Mello?

11 PË. Ajo çfarë më kujtohet mua është që, në fakt, nuk na u dha
12 një dosje, por ishte një version në një fletë, domethënë, një
13 letër në cilën ishte vizatuar një lloj strukture ose
14 organigramë. Z. De Mello, vazhdoi dhe nënvizoi mandatin e tij
15 dhe sikurse ka bërë dhe në raste të tjera më kërkoi mua që të
16 përmendja hollësitë. Pra, të jepja kontekstin dhe argumentet
17 ligjore. Nuk më kujtohen, ndërkohë, hollësitë. Megjithatë, ka
18 pasur një lloj rezistence dhe mendoj që mënyra se si më
19 kujtohet mua është që unë thashë një shprehje që përgjigja
20 ishte më tepër në përputhje me atë çfarë mund të kishte
21 rrjedhur nga Rambujeja po të ishte një mision i një lloji
22 tjetër. Domethënë, unë e kuptova që ata nuk ishin kundër
23 Kombeve të Bashkuara por dëshironin që Kombet e Bashkuara të
24 mund të mbështesnin një Qeveri të Përkohshme të Kosovës. Pra,
25 pak a shumë kjo ka qenë tema e cila është diskutuar dhe çfarë

1 më kujtohet është që kishte një ide të ndryshme të mënyrës se
2 si duhet të vijohet më tej.

3 Pra, diskutimi prej atij momenti në vijim, neve ikëm prej
4 takimit duke e ditur që Qeveria e Përkohshme e Kosovës ishte
5 një sfidë aktuale dhe reale sa i takon kompetencave thelbësore
6 që ishin dhënë përfaqësuesit të posaçëm, Sekretarit të
7 Përgjithshëm sipas Rezolutës 1244.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në paragrafin 26 në
9 deklaratën tuaj ju thoni që mesazhi themelor i udhëheqjes së
10 UÇK-së në përgjigje të shpjegimeve të z. De Mello, për sa i
11 takon Rezolutës 1244 ishte:

12 "Faleminderit për ndihmën, por tani përgjegjës jemi ne.
13 Ne e kemi krijuar Qeverinë e Përkohshme të Kosovës dhe tani
14 neve e drejtojmë vendin."

15 Pyetja ime është kjo, këto janë fjalët tuaja apo këto
16 janë fjalët ekzakte të cilat janë përdorur aty?

17 PË. Jo, janë fjalët e mia. Domethënë është një lloj -- është
18 ajo çfarë unë kam kuptuar prej takimit. Pra, janë fjalët,
19 formulimi është i imi. Është një lloj shpjegimi ose përshkrimi
20 i ndjesisë që unë pata në atë takim, por nuk është citim fjalë
21 për fjalë i asaj çfarë është thënë nga pjesëmarrësit aty.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, ju e keni kuptuar që
23 kjo është qëndrim i udhëheqjes së UÇK-së?

24 PË. Në fakt siç është shprehur në atë takim po.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Por askush nuk i ka përdorur

1 ekzaktësisht këto fjalë, apo jo? Domethënë nuk është citim
2 fjalë për fjalë i asaj çfarë është thënë në takim, apo jo?
3 PË. Me sa më kujtohet mua nuk e përjashtoj si mundësi.
4 Megjithatë nuk është se i kujtoj ekzaktësisht fjalët që janë
5 përdorur aty. Është një përmbledhje e situatës aty dhe një
6 pasqyrim i ndjesisë që unë pata nga ai takim. E kam harruar
7 tani, por gjithsesi ka kaluar shumë kohë, por gjithsesi është
8 një takim i cili ka ndodhur tre ose katër ditë, ose pesë-
9 gjashtë ditë, nuk më kujtohet tani ekzaktësisht; por ka
10 ndodhur në fillim të kohës kur unë kam shkuar në Kosovës.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Tani ju thoni në paragraf
12 për Prokurorinë dhe këtu citoj:

13 "UÇK-ja ishte në dijeni të mangësisë ose boshllëkut që
14 ekzistonte në Kosovë. Kështu që mendoj që motivimi kryesor pas
15 kundërshtimit të kompetencave të përgjithshme të Kombeve të
16 Bashkuara në Kosovë nuk kishte të bënte shumë me testimin e
17 Kombeve të Bashkuara ose me testimin ose kundërshtimin e
18 pranisë ndërkombëtare, por ishte që të largohej shpejt vakumi
19 i krijuar sa i takon grupeve të tjera të shqiptarëve të
20 Kosovës dhe në veçanti Ibrahim Rugovës dhe LDK-së, duke
21 krijuar fakte për këtë terren. Me fjalë të tjera, UÇK-ja nuk
22 po përpiqej që të kundërshtonte domosdoshmërisht praninë e
23 Kombeve të Bashkuara por po përpiqej që të krijonte
24 autoritetin ose kompetencën e vet politike brenda Kosovës.
25 Pra, që të forconte pozicionimin e vet brenda Kosovës, apo jo?

1 A ju kujtohet ta keni thënë këtë?

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Strohmeier, a mund të
4 shtjelloni ose elaboroni më tej marrëdhënien ndërmjet
5 udhëheqësve të UÇK-së dhe PDK-së dhe Ibrahim Rugovës; çfarë
6 keni vënë re ju në takimet që keni pasur me z. Thaçi dhe
7 anëtarë të tjerë të UÇK-së ose Qeverisë së Përkohshme të
8 Kosovës, sa i takon këtij aspekti? A e ka përmendur ndokush
9 tjetër z. Rugova dhe/ose LDK-në?

10 PË. Të nderuar Gjykatës, ky hendek ose ky boshllëk që unë kam
11 përshkuar, ose kam vënë re, ishte i qartë për të gjithë. Unë
12 mund të them që e kam përshkruar këtë edhe në rastet të tjera.
13 I kemi dëgjuar të gjitha këto gjëra. Ne kemi ndjerë një lloj
14 situatë të tillë dhe kemi të bëjmë me një peizazh politik,
15 domethënë, ku z. Rugova ishte Presidenti në ekzil.

16 Dhe në disa raste më kujtohet që kam dëgjuar znj. Tahiri,
17 po kam dëgjuar gjithashtu edhe persona të tjerë nga LDK-ja që
18 ata po prisnin Rugovën. Dhe në mungesë të z. Rugova më
19 kujtohet që ne kishim ndjesinë që LDK-ja kur ndërvepronte me
20 ne kur kishte takime me ne po përpiqej që të mbante akoma
21 vendin e ngrohtë, pavarësisht, domethënë, që ata e
22 kundërshtuan që të merrnin pjesë në KTK në fillim fare. Por
23 situata ishte e tillë, domethënë, në këtë lloj konteksti, pra,
24 Rugova nga njëra anë nuk kishte aty, por nga ana tjetër LDK-ja
25 në terren ose persona me të cilët kishin ndërveprim, kishim

1 bashkëbisedime duket sikur ishin të cenuar, ose të pamundur
2 për sa i takon kompetencave të tyre vendimmarrëse.

3 Ndërkohë, që udhëheqja e UÇK-së ishte shumë më tepër
4 koherente, ishte goxha më e qartë, por edhe më shumë kërkuese
5 lidhur me rrugën përpara. Pra, kjo ishte situata që UÇK-ja
6 ishte më e vendosur, e dinte se në çfarë drejtimi po shkonte
7 dhe sikurse e thashë edhe më përpara ata ishin pala që po
8 flisnin për Qeverinë e Përkohshme të Kosovës. Ata ishin
9 personat që po kundërshtonin të drejtën e zbatueshme, nuk po
10 them këtu për më mirë ose për më keq, por gjithsesi kjo ishte
11 situata. Pra, gjithmonë e më tepër, udhëheqja e UÇK-së ishte
12 pika të cilës ne i drejtohemi për çështje që kishin të bënin
13 me rolin tonë të mëtejshëm për projektimin e mandatit të
14 UNMIK-ut ose realitetit të UNMIK-ut. Dhe në qoftë se do kishte
15 pasur një forcë tjetër të dytë -- e fortë e cila ndonjëherë
16 ndoshta ishte pajtuar me ndonjëherë dhe kishte kundërshtuar,
17 situata do kishte qenë e ndryshme, sepse do kishim pasur një
18 situata me dy kahe të ndryshme dhe jo një situatë vetëm me një
19 bosht kryesor. Pra, situata ishte e tillë që z. Rugova nuk
20 ishte i pranishëm, por erdhi një momenti kur ai u kthye dhe në
21 përgjithësi edhe sa i takon nivelit të udhëheqjes në cilën
22 kisha akses UÇK-ja në fakt ishte strukturë që do të formësonte
23 të ardhmen e menjëhershme të Kosovës. Të paktën kjo ishte
24 përshtypja ime në ditët e para dhe kjo mbështetej nga situata
25 në terren. Ndërkohë që pjesa tjetër e çështjeve që, për

1 shembull, arrestimet, ndalimet ose ndonjëherë personat të
2 cilët vishnin uniformë dhe vetidentifikoheshin si pjesëtarë të
3 UÇK-së. Dhe nuk mund t'ju them me siguri në qoftë se në disa
4 raste ata kishin uniforma të rreme ose kishte -- në të gjitha
5 rastet uniformat ishin të rreme; nuk mund ta them dot këtë
6 gjë.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që po ju
8 ndërpres, por pyetja ime ishte paksa ndryshe nga shpjegimi që
9 na dhatë.

10 Pyetja ime ishte kjo: A mund të përshkruani sjelljen e
11 përgjithshme të z. Thaçi ose anëtarëve të tjerë të UÇK-së,
12 pra, të udhëheqjes së UÇK-së, në raport me z. Rugova dhe LDK-
13 në. Domethënë, në veçanti e kam fjalën për takimin që keni
14 pasur ju me z. Thaçi.

15 PË. Unë personalisht nuk kam dëgjuar nga z. Thaçi ose nga
16 askush tjetër, ose të paktën me aq sa më kujtohet, nuk më
17 kujtohet të kemi diskutuar konkretisht për z. Rugova.
18 Megjithatë, pas disa dokumenteve që unë pashë, pra, u sugjerua
19 që më duhej që të vazhdonim më tej, megjithatë, me fjalë -- me
20 pak fjalë nuk kam dëgjuar asgjë të thuhet për z. Thaçi.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Domethënë, nuk keni dëgjuar
22 as deklarata pozitive?

23 PË. As pozitive.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në paragrafin 57 ju thoni,
25 që sipas pikëpamjes tuaj vala e dhunës kundër serbëve në

1 Kosovë pas tërheqjes së armatës jugosllave ose forcave serbe
2 nuk kishte rastësore, por ishte masive, ishte e qenësishme.
3 Dhe që "ka çuar në një proces të organizuar me dimensione të
4 mëdhaja që shkonin shtëpi më shtëpi dhe ishte e drejtuar
5 konkretisht te serbët."

6 A ju kujtohet ta keni thënë këtë gjë, Dëshmitar?

7 PË. Po.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na e shpjegoni si
9 keni mbërritur ju në këtë përfundim?

10 PË. Sikurse aluduat dhe në fillim, disa prej këtyre
11 deklaratave janë bërë në kushte të tilla, që, për shembull,
12 disa prej deklaratave i kam dhënë pas dhjetë vitesh mbasi ka
13 ndodhur -- mbasi kam qenë në Kosovë dhe besoj që atëherë unë i
14 kam kujtuar gjëra më mirë sesa që i kujtoj tani. Në disa
15 vende, si për shembull, në Prizren, më kujtohet që ka pasur
16 lagje të tëra të jetuara nga serbët ku ka pasur djegie çdo
17 ditë. Për shembull, Prizreni na tërhoqi vëmendjen që në fillim
18 fare. E thashë edhe dje, edhe për shkak të zjarrvënieve, për
19 shkak të incidenteve që ndodhnin çdo ditë.

20 Dhe meqenëse ra fjala, situata nuk ishte e tillë vetëm
21 thjesht në Prishtinë ose nuk ishte një situatë rastësore këtu
22 apo aty, ose ka pasur -- këto kanë qenë incidente që ndodhnin
23 rëndomë ose, për shembull, kishte raste kur një familje
24 dëshironte që të shkonte të zaptonte shtëpinë e një serbi të
25 larguar. Për shembull, më kujtohet njëri prej anëtarëve të

1 panelit të trupit gjykues të përkohshëm që kishte -- ishte
2 rasti i një serbi që kishte shërbyer për një javë ose dy javë
3 dhe që ishte kërcënuar disa herë ku njerëzit shkonin te dera e
4 shtëpisë së tij, trokisnin aty në derën e shtëpisë. Deri në
5 atë masë, pra, situata ishte kaq serioze sa oficerët e UNMIK-
6 ut ose të OSBE-së shkuan për të fjetur atje për disa ditë
7 gjatë natës, pra.

8 Po ashtu kam dëgjuar edhe raportime gojore nga njerëz ose
9 gjithashtu edhe raportime zyrtare nga kolegët tanë në rajone
10 për akte të tilla. Domethënë, të shpërndara nëpër të gjithë
11 vendin për akte të tilla të cilat ishit të etiketuar drejt një
12 grupi të caktuar. Pra, kryesisht serbëve, e kam fjalën këtu.
13 Për shembull, në rastin e këtij serbit që unë ju thashë
14 situata ndodhi pas caktimit të tij si gjykatës. Ndërkohë që
15 pas disa javësh ai u larguar fare nga Kosova për shkak të
16 zhvillimeve kundër tij, familjes së tij.

17 Pra, sërish kjo ishte përshtypja jonë. Megjithatë, nuk
18 mund të përjashtoj faktin që këto mund të ishin akte
19 individuale, domethënë, akte të individëve të caktuar.
20 Megjithatë, ndjesia jonë ishte që incidente të tilla ishin të
21 shpeshta në ato kohë. Kështu që ishte e vështirë që të
22 kthyerit mund të shkonin në shtëpitë e tyre. Edhe mendoj që ka
23 qenë një përpjekje më sistematike. Megjithatë, u mundova që ta
24 thoja dhe dje, por dua ta nënvizoj që sa i takon cilësimeve
25 juridike mund të kërkoj që të gjendet një politikë e caktuar.

1 Unë jodomosdoshmërisht mund të them që ka pasur një politikë të
2 deklaruar që të mund të ndiqeshin politikat e vrasjes ose të
3 dëbimit, ose edhe të dhunës kundër një grupi të caktuar. Nuk e
4 them këtë gjë. Megjithatë, ajo çfarë dua të them edhe një
5 herë, mendoj që mjedisi ka qenë mundësues për krime të tilla.
6 Në disa raste ka pasur edhe një lloj mbështetje. Megjithatë,
7 më duhet të them që incidentet ishin të ngjashme dhe
8 pavarësisht që nuk ishin të lidhura të dukej sikur modeli
9 ishte aty, domethënë kishte -- ndiqej i njëjti model krimesh
10 të kryera, për shembull, kundër shtëpive ose lagjeve të
11 caktuara.

12 Ju kërkoj ndjesë; ndoshta nuk jam shumë i qartë, por ju
13 kërkoj ndjesë për të qenit i shpërndarë.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Jo, është e qartë, të paktën
15 unë e kam të qartë.

16 Tani do të kalojmë në një temë tjetër. Z. Strohmeier, dje
17 ju bëri pyetje Mbrojtja e Thaçit për FARK-un, jo për FARK-un e
18 Kolumbisë, por për një tjetër FARK. Pra, a ka pasur një
19 formacion tjetër paramilitar të pranishëm në Kosovë në vitin
20 1999, ju kujtohet kjo? Jua bën këtë pyetje.

21 PË. Po, më kujtohet pyetja.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në faqen 133 të transkriptit
23 në kohë reale, ju thoni që nuk e kujtoni FARK-un ose citoj
24 këtu që "FARK-u nuk është identifikuar në asnjë prej takimeve
25 si një prej arsyeve kryesore të shqetësimit për sa i takon

1 situatës së sigurimit në Kosovë ...”

2 Pyetja që kam për ju është kjo: A ju kujtohet FARK-u apo
3 sjellja e anëtarëve të FARK-ut si një prej arsyeve, jo si
4 arsye kryesore, por një prej arsyeve të shqetësimit të
5 aspekteve të sigurisë në Kosovë?

6 PË. Kam përshtypjen që dje thashë që nuk më kujtohet, pra,
7 nuk më kujtohet FARK-u, fare. Kjo nuk do të thotë që e
8 përjashtoj FARK-un fare. Megjithatë, dua të them që fakti që
9 kjo nuk më thotë asgjë, nuk më ka ngelur në mendje, nuk më
10 kujtohet asgjë lidhur me të; të paktën kjo më thotë që kjo
11 është diçka që në atë kohë nuk ishte e rëndësishme për mua.
12 Ose të paktën nuk s’e kam kapur në atë kohë.

13 Kështu që kur kam parë javën e shkuar dhe gjatë dy ditëve
14 të fundit raportet që janë shkruar dhe ku thuhej UÇK, UÇK, UÇK
15 nuk e kam fjalën për sot, në fakt. Por e kam fjalën për
16 përshtypjen e krijuar. Mbase është përshtypje e gabuar, mbase
17 ka pas një FARK. Ndoshta janë bërë kapje, ndalime nga FARK-u e
18 të tjerë e të tjerë, megjithatë, mua nuk më kujtohet dhe në
19 raporte nuk pasqyrohet kjo. Në qoftë se ti je në anën tjetër
20 dhe në qoftë se, për shembull, detyra jote është që të krijosh
21 trupa gjykses ose sa herë që të shikosh situatën e sigurisë e
22 ku di unë të bësh akte ligjore të rëndësishme për të krijuar
23 strukturat atëherë sigurisht që përshtypja në këtë pozicion do
24 të krijojë që elementi kryesor ose forca kryesore ishte UÇK-ja
25 dhe jo forca të tjera.

1 Kështu që duhet parë në këtë kontekst. Kështu që në
2 përmbyllje dua të them që as nuk më kujtohet as nuk besoj nga
3 asgjë që kam shkruar apo çfarë më kujtohet që FARK-u ka qenë
4 problem asokohe. Dhe as nuk bëhet fjalë që FARK-u ishte në të
5 njëjtin nivel problemi siç kishin identifikuar neve me UÇK-në.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull tani. Do ju bëj
7 një pyetje tjetër për t'ju thënë se çfarë ju kujtohet. Është
8 në të njëjtin kontekst ose në njëjtin aspekt. Atëherë lidhur
9 me këtë dhe në këtë kontekst është një sjellje e pjesëtarëve
10 të grupeve të armatosura të tjera joshtetëror apo organizata
11 në Kosovë ajo ishte çështje shqetësimi në takime në të cilat
12 ju morët pjesë në Kosovë, përveç UÇK-së?

13 PË. Përveç UÇK-së --

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Përveç UÇK-së.

15 PË. Në qoftë se i referohem takim që kam marrë pjesë, pra, ku
16 kam marrë pjesë, te Komisioni për Implementim nuk më kujtohet
17 që kemi pasur diskutime të tjera. Edhe dy ditët e fundit nuk
18 kam parë, në fakt, përveç këtij raporti konkret në kontekstin
19 e FARK-ut. Nuk -- ishte gjithmonë, pra, Gjenerali Jackson apo
20 De Mello apo kush që i bënin thirrje z. Thaçi dhe udhëheqjes
21 së UÇK-së që të ndërhyjnë dhe të dërgonin mesazhe publike
22 kosovarëve, popullsisë së Kosovës. Kishte edhe deklarata të
23 përbashkëta, natyrisht, por gjithmonë në kontekstin e UÇK-së,
24 e cila ishte identifikuar si forma kryesore në terren, dhe jo
25 FARK-u apo ndonjë grup tjetër jashtë FARK-ut. Nuk më kujtohet

1 ndonjë grup tjetër. S'do të thotë që nuk ka patur, por unë nuk
2 -- mua nuk më kujtohen.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Ju kujtohen
4 krimet që pretendohen të jetë kryer nga persona që pretendohet
5 të ishin të UÇK-së, që pretendonin të ishin pjesëtarë të UÇK-
6 së, për shembull, që vishnin uniformat e UÇK-së?
7 PY. Ka patur diskutime lidhur me ndalimet e paligjshme. Disa
8 persona iu referohen këtyre si kidnapime, që është një formë
9 tjetër e ndalimit të personave dhe mbajtja e tyre në ndalim,
10 në qendër-ndalimi në raporte ndoshta ka dhe gjëra të tjera
11 fizike, ndoshta dhe vrasje, por nuk më kujtohet kujt i
12 atribuoheshin këto në hollësi.

13 Tani që të kthehem para 25 vitesh do të shoh situatën në
14 tërësi. Kjo paraqitej sidomos në javët e para se UÇK-ja
15 përpiqej të krijonte praninë e saj në terren, ishte e
16 pranishme në terren. Dhe kurdo që të bëhej fjalë për arrestime
17 ato ishin bëheshin nga KFOR-i dhe jo gjithmonë, por në pjesën
18 më të madhe të rasteve ishin pjesëtarët e UÇK-së që mbanin
19 armë e kështu me radhë. Pra, më kujtohet disa dokumente që kam
20 parë sot që i referohen Gjeneralit Jackson. Bëhej fjalë për
21 karta identiteti të njësive që ishin ndaluar.

22 Pra, këto gjëra kanë vazhduar deri në mes të gushtit dhe
23 -- më vonë. Përveç -- përtej incidenteve -- individuale për
24 neve ishte një sërë sasi e madhe incidentesh që ndodhnin çdo
25 ditë dhe e vetmja forcë, jo sepse dua që të jetë kështu, por

1 sepse kështu më kujtohet, dhe i vetmi aktor, aktor joshtetëror
2 i armatosur që më kujtohet lidhur me këtë ishte UÇK-ja. E
3 vetmja që ka krijuar institucione paralele duke kundërshtuar
4 mandatin që ne kishim nga Rezoluta 1244 ishte UÇK-ja.

5 Nuk -- më kujtohet diçka konkrete lidhur me LDK-në apo që
6 LDK-ja ka krijuar ministri të tjera konkrete të ndara
7 funksionale. Përsëri nuk do të thotë që s'ka ndodhur apo që
8 nuk ishte plan diku, por nga shkëmbimet e mia dhe ndërveprimet
9 e mia nuk më kujtohet kjo gjë.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Paragrafi 76 i
11 deklaratës tuaj, ju deklaroni se ligji zbatues -- çështja e
12 ligjit të zbatueshëm të cilin ju e keni diskutuar personalisht
13 me z. Thaçi u "pika e kthjellimit për të diskutuar çështje të
14 tjera, përfshirë qendrat e ndalimit." A ju kujtohet kjo?
15 PË. Po.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Strohmeyer, a mund ta
17 përshkruani shkurtimisht qëndrimin që mbajti z. Thaçi gjatë
18 bisedimeve tuaja lidhur me qendrat e ndalimit që pretendohej
19 të drejtoheshin nga UÇK-ja? Shkurtimisht.

20 PË. Nuk më kujtohet tamam me saktësi biseda lidhur me qendrat
21 e ndalimit, sepse ne ishim të përqendruar te ligji i
22 zbatueshëm në bisedimet tona. Ishte, dhe siç e thashë, ishte
23 bisedë miqësore, konstruktive gjatë së cilës -- mora përgjigje
24 për ato që ishte kureshtja ime, bëra pyetje për Shqipërinë.
25 Spekulohej në atë kohë, ekspertët e tjerë që kjo bëhej fjalë

1 për Shqipërinë e madhe që në fakt nuk ishte e vërtetë. Pra, në
2 varg të kësaj biseduam edhe për qendrat e ndalimit; nuk më
3 kujtohet hollësitë lidhur me këtë pikë. Nuk më kujtohet se si
4 shkoi ky diskutim.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në paragrafin 92 të
6 deklaratës tuaj, thoni që z. Thaçi "premtoi që do të bënte
7 gjithçka që ishte në mundësinë e tij, përshirë nxjerrjen e një
8 deklaratë, lëshimin e një deklaratë zyrtare për të bërë --
9 zhbërë qendrat e ndalimit të UÇK-së." A ju kujtohet?
10 PË. Më kujtohet që ka qeni diskutim dhe me sa kuptoj unë të
11 paktën, nëse kjo lidhje me njërin prej rasteve që diskutohet
12 në deklaratë që m'u paraqit mua. Po kështu e kam kuptuar unë.
13 Dhe natyrisht që ishte një kërkesë nga ana jonë që të bëhej
14 thirrje UÇK-së apo kosovarëve që të mos ndërmerren veprime të
15 tilla.

16 Nuk më kujtohet hollësitë e të gjitha deklaratave tani,
17 por di që kemi -- kam biseduar lidhur me këtë.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ju tha z. Thaçi se cilët
19 hapa konkret do të merrte për të zgjidhur këtë problem,
20 çështjet e tensionit, përveç deklaratave, nxjerrjes së
21 deklaratave?

22 PË. Nuk më -- nuk mendoj që kemi hyrë në thellësi në këtë
23 bisedë. Ka qenë më shumë ndoshta si pikë më e gjerë; e kam
24 fjalë që tiparet kryesore, kyçe, një prej tipareve kyçe apo
25 një prej pikave kyçe më pyetët më herët sot. E kam fjalën për

1 ndalimet dhe rrëmbimet apo kidnapimet. Shqetësimi i madh i
2 joni ishte, sepse nuk ishte thjesht një incident kundër një
3 individi. Kjo ishte në të njëjtën kohë një sfidë për neve dhe
4 mandatin tonë.

5 Dhe në këtë kontekst ndoshta lidhur me këtë çështja e
6 pushtetit apo autoritetit që përmenda lidhur me qendrat e
7 ndalimit. Është paraqitur por nuk më kujtohet -- më kujtohet,
8 pra, në pikëpamjen operacionale në hollësi, se si mund të
9 bëhej kjo dhe nuk kam, nuk më kujtohet qartë diçka më shumë
10 përveç deklaratave lidhur me çështjet operacionale.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini nëse z. Thaçi ka
12 bërë diçka përveç lëshimit të deklaratave?

13 PË. Nuk e di.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe në fund, z. Strohmeier,
15 Prokurorisë i keni thënë në paragrafin 92 të deklaratës tuaj,
16 po citoj:

17 "Fushata e vazhdueshme në mos -- ose sistematike kundër
18 serbëve të Kosovës mund të ketë ndodhur -- nuk mund të ketë
19 ndodhur pa minimalisht mbështetjen e z. Thaçi në mënyrë të
20 pashprehur. Nga një anë ai na thoshte ne që administratat
21 lokale po funksionin mirë, nga ana tjetër ai na thoshte që
22 qytetet kishin vetëkrijuar qeveri vendore dhe që qeverisnin
23 vetë."

24 A ju kujtohet që keni thënë këtë Prokurorisë?

25 PË. Në një pikë gjatë intervistës më kujtohet, po.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po tani po ju pyes, a besoni
2 akoma sot që z. Thaçi dinte se çfarë po ndodhte në Kosovë që
3 po përdor fjalët e tua tani që ishte një fushatë e
4 vazhdueshme, e ndoshta dhe sistematike e krimeve kundër
5 serbëve të Kosovës dhe pakicave të tjera dhe që ai ose e ka
6 mbështetur këtë ose -- siç thashë ju, nuk e ka denoncuar këtë
7 fushatë. Ka pranuar me një fjalë të tjera? A është kjo që
8 besoni sot apo kemi ndonjë keqkuptim këtu?

9 PË. Pika e parë është deklaratë faktike. Pra, besoj që ka
10 qenë shumë e vështirë që të mos e dinte -- lidhur me këtë.
11 Tani nëse z. Thaçi apo qoftë kjo për z. Thaçi apo për dikë
12 tjetër. Pra, ishte shumë e vështirë që të mos e dinin. E kam
13 fjalën kjo po ndodhte çdo ditë. Për këtë njerëzit po flisnin
14 dhe pas dy javësh, tre javësh ne e dinim, njihnim shumë njerëz
15 në Prishtinë vetë, juristë dhe të tjerë dhe ndonjë uleshim,
16 pinim kafe, bisedonim për atë që po ndodhte dhe nuk është,
17 pra, që vetëm ne e dinim këtë në UNMIK. Sepse kishim qasje në
18 dokumentet, informacionet nga KFOR-i dhe OSBE-ja. Të gjithë e
19 dinin këtë. Pra, mendoj që kjo ishte e ditur edhe për të
20 tjerë, përfshirë këtu, mendoj këtu z. Thaçi i cili mund ta --
21 ka patur mundësi ta dinte që këto gjëra po ndodhnin.

22 Sa i takon fushatës sistematike të vazhdueshme, e
23 vazhdueshme sepse ishte nuk -- bëhej fjalë për 10.000
24 refugjatë që po ktheheshin dhe ishte lëvizje shumë e
25 vazhdueshme, pra, lineare. Pra, momenti kur ata janë kthyer në

1 Kosovë ata janë shpërndarë në bashkësi, komunitete të tyre --
2 përkatëse dhe në ato ditë kur ishte kthimi i madh dhe ishte --
3 u rrit dhuna në mënyrë të madhe pastaj qetësohej dhe kjo ishte
4 e vazhdueshme në kuptimin që ka zgjatur për javë të tëra.

5 Dhe kur folëm dje lidhur me faktin se në nëntor apo më
6 vonë të atij viti këto gjëra ishin qetësuar dhe nuk ishin aq
7 të shpeshta më shumë. E kam fjalën se kishte shumë dhunë dhe
8 dëbime apo tërheqje të serbëve që kishin ndodhur në ato javë
9 të para. Dua të them që ndoshta nuk kishin ngelur aq shumë
10 serbë tani më në Kosovë në atë periudhë kohore, pra, në tetor
11 apo nëntor dhe krahasimisht me aq sa ishin në qershor dhe
12 korrik. Pra, në këtë periudhë kohore, termi "të vazhdueshme"
13 ishte -- do të thoshte në baza ditore.

14 Sa i përket sistematike, në kuptimin siç e kam shpjeguar
15 më parë, unë kisha përshtypjen që nuk ishin thjesht akte të
16 palidhura apo të izoluara të dhunës ku serbi takohej në rrugë
17 për të shkuar në treg dhe rrihej apo gjëra të tilla. Më
18 kujtohet një ngjarje kur një grua e moshuar na tha ne që
19 kishin shkuar në shtëpi, trokitur në derë dhe tha -- i kishin
20 thënë duhet të largohesh nesër. Më kujtohet shoferi, që siç e
21 thashë dje, i cili më çoi në Shkup dhe punonte për OSBE-në dhe
22 -- apo UNMIK-un. Vinte nga një komunitet pakice joshqiptare
23 myslimane dhe tha, "Familja ime ka jetuar këtu për 350 vjet.
24 Do të largohem javën që vjen, do të shkoj ne Stamboll sepse na
25 kanë thënë, nuk jeni këtu, nuk keni vend këtu."

1 Duhet të kishim shumë gjëra të tilla sa na kanë bërë, na
2 kanë çuar të mendojmë, besoj se këtu nuk bëhej fjalë për gjëra
3 të izoluara këtu, por ishte diçka sistematike kur të gjithë që
4 shiheshin apo si të lidhur me regjimin paraparak apo me serbët,
5 nuk do ishin -- ishin të padëshiruar -- ata që ishin të
6 padëshiruar për arsye të tjera.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja ime e fundit, lidhur
8 me atë që z. Thaçi mbështeste këto veprime kundër serbëve dhe
9 minoriteteve. Ju dëgjuat dje nga Mbrojtja, prova që ju tregua
10 juve që z. Thaçi jepte -- ka bërë fjalime dhe ka bërë fjalime
11 ku bënte thirrje për paqe, pajtim duke përdorur fjalët tani,
12 dhe përfshirjen e pakicave etnike. Çfarë ju bën juve të
13 mendoni që ai ka -- nuk ka denoncuar apo ka mbështetur në
14 njëfarë forme ka pranuar krimet kundër pakicave dhe në veçanti
15 serbët?

16 PË. Siç e thashë dje ishte një mjedis që e inkurajonte këtë,
17 ishte një perceptim dhe duhet të shihen se thirrjet e bëra
18 ndaj z. Thaçi kanë vazhduar dhe nuk ishte vetëm një herë, nuk
19 u bë vetëm një herë që ne të ishim të kënaqur pastaj me këtë.
20 Të bindur, kishte -- kjo është bërë në mënyrë të përsëritur
21 dhe pastaj mendoj që dokumenti i fundit që më është treguar
22 dje ishte një artikull shtypi i gushtit ku Gjenerali Jackson
23 përsëri ishte i zemëruar dhe është kthyer aty. Pra, kjo ka
24 vazhduar.

25 Pra, pas njëfarë kohe. Mund të mendohej që në rregull po

1 jepnin deklaratat e duhura, por pastaj situata në terren nuk
2 po ndryshonte dhe në të njëjtën kohë ai paraqitej vetë dhe
3 lidershipi, neve -- si i tillë, por në një prej takimeve të
4 Komisionit për Implementim, duke thënë që, "kemi një
5 organizatë që kontroll këto ngjarje", gjë që mund të ishte apo
6 mund të ketë apo jo e vërtetë.

7 Pra, për neve ishte një përshtypje e qartë, edhe për këtë
8 arsye kemi shkuar te z. Thaçi. Ky ishte pritja, pritshmëria
9 jonë ishte që të ndalohej kjo që të paktën të uleshin këto
10 tensione dhe jo vetëm, edhe më tej, dhe jo vetëm përmes
11 deklaratave, por nuk di se çfarë veprimesh disiplinore ishin
12 ekzistuese apo mund të merreshin atë kohë brenda UÇK-së. Por
13 përjashtimi çfarëdo që do të thoshte kjo do të ndërmerrej
14 diçka dhe do të raportohet lidhur me këtë. Nuk më kujtohet të
15 këtë ndodhur.

16 Pra, ajo që po them nuk kam prova të asnjë natyre që z.
17 Thaçi personalisht ka inkurajuar apo nxitur apo ka thënë që,
18 në rregull tani është mirë që ky person të hiqet qafe, por
19 bashkërisht me atë kundërshtim të fuqishëm ne kishim
20 perceptimin, pra, kundërshtimi i fuqishëm, edhe këtu po
21 parafrazoj se nuk më kujtohet hollësitë e bisedës, kjo është
22 vendi i kosovarëve tani dhe duhet ta krijojmë, t'i japim
23 formë.

24 Dhe të gjitha këto së bashku na kanë dhënë përshtypjen
25 neve, krijuan përshtypjen te ne që ishte një realitet që

1 shprehej në takime dhe politikë dhe në deklaratë dhe një
2 realitet tjetër lejohen -- të vazhdonte. Tani nëse kjo është
3 një formë mbështetje apo nxitje nuk po e them këtë. Por neve
4 patëm përshtypjen që ekzistonte një mjedis një atmosferë që e
5 nxiste këtë gjë apo e bënte të mundur apo e toleronte.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. S'kam pyetje
7 të tjera.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Mirëdita, z. Dëshmitar.

10 Z. Sekretar, a mund të shfaqni në ekran dokumentin
11 P01444.

12 Z. Strohmeier, gjatë marrës në pyetje nga Mbrojtja ju
13 tregua një dokument me datën - i datës 21 qershor 1999, i
14 nënshkruar nga z. Thaçi dhe Gjenerali Mike Jackson.

15 Kalojmë në faqen e fundit të dokumentit ku shihen
16 nënshkrime. Pak më poshtë.

17 Këtu shohim, z. Thaçi nënshkruan në cilësinë e tij si
18 komandant kryesor -- kryekomandanti i UÇK-së. A është kjo në
19 përputhje me atë që keni kuptuar ju lidhur me pozicionin e z.
20 Thaçi në atë kohë?

21 PË. Që të jemi i ndershëm, i sinqertë, kur më është treguar
22 ky dokument u habita që ai ka nënshkruar si kryekomandant i
23 UÇK-së, sepse mendoj është në përputhje -- përputhet mënyra se
24 si na është prezantuar neve. Ai u prezantua më shumë si
25 udhëheqës politik.

1 Por ne ishim Kombet e Bashkuara, merreshim me çështje
2 civile dhe natyrisht që ai nuk do të kishte folur
3 domosdoshmërisht me z. De Mello si kryekomandant apo komandant
4 ushtarak sepse nuk trajtoheshin çështje ushtarake, por civile.
5 Por kjo gjë mund të ketë qenë shumë më e qartë për -- ose me
6 Gjeneralin Jackson.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në shkëmbimet tuaja kur
8 ishit me z. De Mello, shkëmbimet e tuaja me të, si u prezantua
9 z. Thaçi përpara jush, në çfarë cilësie, a përdori ndonjë
10 titull formal?

11 PË. Më është bërë kjo pyetje më parë, nëse ai i referohej
12 vetes si kryeministër apo u prezantua si i tillë, nuk më
13 kujtohet një gjë tilla. Të jem i sigurtë nuk më kujtohet
14 mënyra e prezantimit të tij apo ndonjë titull. Nuk mendoj
15 ndoshta pas një apo dy takimesh kjo s'kishte më, nuk ishte më
16 e nevojshme të bëhej, sepse ishte e qartë që ai -- çfarë
17 përfaqësonte ishte personi me të cilin ne komunikonim dhe nuk
18 tha, as nuk tha që, "Jo, në rregull, prit një sekondë, mos më
19 fol, fol me dikë tjetër", përveç nëse bëhej fjalë për çështje
20 teknike dhe as nuk e ka bërë këtë z. Rugova, që të thojë prit
21 pak, fol me z. Thaçi, bisedo me atë, duhet të flasim me të
22 tjerë.

23 Ishte qartë, më e qartë se z. Thaçi ishte personi me të
24 cilin do të komunikonim kryesor në terren, në veçanti gjatë
25 kohës që z. Rugova ishte jashtë vendit.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A mund të qartësoni si e
2 kuptuat ju marrëdhënien mes z. Thaçi dhe z. Agim Çeku, sa i
3 takon çështjeve ushtarake, si e kuptuat -- kush kuptuat --
4 menduat ju që ishte më epror ndaj tjetrit sa i takon lidhur me
5 komandën e UÇK-së?

6 PË. Që të jem tërësisht i sinqertë në takimin e parë që ishte
7 ky shënimi, takimi i parë, dita pas nënshkrimit të angazhimit
8 më datën 22, takimi i parë i Komisionit për Implementim,
9 çështje që kishin të bënin me zbatimin e kësaj marrëveshje;
10 ishin të gjitha çështje ushtarake operacionale.

11 Dhe nuk më kujtohet të kem -- të më jetë thënë apo të kem
12 patur, të më jetë sugjeruar ndonjë gjë që lidhur me pika të
13 caktuara do të trajtoheshin me z. Thaçi më shumë. Pra, në këtë
14 takime -- ai duket të ishte i plotfuqishëm lidhur me këtë.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në deklaratën tuaj, ju e
16 përshkruat z. Çeku si shefi i shtabit të UÇK-së - z. Çeku - më
17 falni si shefi i shtabit të UÇK-së në deklaratën tuaj me
18 shkrim në këtë Gjykatë. A kishit ju pikëpamje apo një mendim
19 përveç këtij dokumenti se kush ishte komandant -- shef i
20 shtabit të UÇK-së?

21 PË. Nuk mendoj -- mendoj që titulli është diku, e kam parë
22 dje diku, ndoshta shefi i shtabit të përgjithshëm apo çfarë do
23 që të jetë.

24 Ishte titull ushtarak. Për neve, në qoftë se mund të flas
25 në këtë terma teknikë. Kreu i UÇK-së ishte z. Thaçi. Nuk më

1 kujtohet të kem patur ndonjë dyshim lidhur me këtë apo dikush
2 të më ketë thënë që, "nuk është kështu, është dikush tjetër".
3 Tani konkretisht se si saktësisht -- se si ishte organizuar
4 hierarkia nga brenda nuk e di. Dhe e thashë edhe dje me sa më
5 kujtohet nuk kam parë asnjëherë kurrë ndonjëherë organigramë
6 të UÇK-së.

7 Nuk kam marrë raporte për këtë. Ajo që më kujtohet po
8 ashtu në këtë takim është një -- takim me Sergio de Mello,
9 disa ditë pas takimit të dytë të Komisionit për Implementim
10 lidhur -- takim për çështje të policisë etj., biseduam me z.
11 Thaçi, ai foli dhe tha, "Për çështje që kanë të bëjnë me UÇK-
12 në, integrimin në forcën e policisë e kështu me radhë duhet ta
13 trajtoni këtë me z. Çeku". Në qoftë se kjo jep ndonjë
14 përshtypje të gradës apo rangut në ushtri. Kjo është e vetmja
15 gjë që më kujtohet, sa i takon vartësisë në hierarkinë
16 ushtarake. Nuk kam dëgjuar asnjëherë z. Çeku të thotë, "jo nuk
17 kam pushtet të vendos për këtë autoritet duhet të trajtoj këtë
18 me z. Thaçi", që nuk do të thotë që nuk ishte realiteti. Mua
19 nuk më kujtohet dhe përveç këtij incidenti nuk më kujtohet që
20 z. Thaçi të ketë thënë "Kjo nuk është përgjegjësi e imja," apo
21 "Ky person -- me këtë person nuk mund të flisni; duhet të
22 flisni me mua, sepse jam personi që vendos përfundimisht."

23 Për neve ishte e qartë që personi me të cilin duhej të
24 trajtonim për të gjitha këto çështje nuk kam patur, pra,
25 ndonjë situatë ku ne jemi -- kemi kontaktuar z. Thaçi lidhur

1 me një pikë me çështjen e mbylljes së qendrave të ndalimit apo
2 uljes së tensioneve apo qetësimit të situatës ku ai të ketë
3 thënë, "Kjo nuk është përgjegjësi e imja, sepse nuk jam --
4 sepse jam përgjegjës vetëm për këtë pjesë të organizatës. Kjo
5 është përgjegjësia e dikujt tjetër". Pra, nuk më kujtohet kjo.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Thjesht për qartësim. Kur ju
7 thoni, "Ai ishte personi tek i cili duhej të adresoheshin për
8 të gjitha këto palë, këto çështje", që të qartësojmë, kur
9 thotë -- që ta qartësojmë kur thoni, "ai" --

10 PË. Z. Thaçi.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] I referohet z. Thaçi.

12 PË. Z. Thaçi.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju
15 faleminderit, Dëshmitar. Duhet të vini nesër në orën 09.00 që
16 të mbarojmë me dëshminë tuaj. Ju urojmë që të mos zgjasë
17 shumë. Faleminderit për praninë tuaj sot. Mos bisedoni me
18 askënd lidhur me dëshminë tuaj. Do shihemi nesër në mëngjes.

19 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

20 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka dikush
22 ndonjë gjë? Nuk ka.

23 Seancë mbyllet. Shihemi nesër në orën 09.00.

24 --- Seanca mbyllet në orën 16.32

25